

**Piktori Ismail Lulani,
kumtuesi i epshit të
ngjyrave shpuese dhe
poetikës shprehëse**

FAQE 49-51



**Gruaja malësore
në foto, thesari i
trashëgimisë sonë
shpirtërore**


FAQE 42-45



**Karagjorgje,
kelmendasi që
themeloi dinastinë
sunduese serbe**

FAQE 31-32

Zani i Malsisë ^{FREE} INC.



**Kral Nikolla
"Skënderbeu"
i malsorëve?!**

FAQE 8-10

**Të parët e
Kelmendit erdhën
nga Trieshi**

FAQE 11-13

...TIVE, HISTORIKE DHE PATRIOTIKE Botues; Vasel GILAJ, Viti II i botimit, Nr 2, New York, PRILL 2018 hotian98@gmail.com



**Kur Turqia dhe
Bullgaria kërkonin
bashkimin e Kosovës
me Shqipërinë**

FAQE 39

**Pse shqiptarët
katolikë ndërtojnë
Kisha ortodokse
në Malin e Zi?!**

FAQE 11-13

**Çun Lajçi, ushtima
e kijametshme e një
kushtrimi hovesh
kryengritëse**

FAQE 20-22

**Si shpëtoi Dedë Gjo'
Luli në Vraninë?**

FAQE 34-35



Alba-Kos alësia Tours



Your vacation is our business



AIRLINE TICKETS
Domestic & International



Dedë Dedvukaj

Honeymoon Packages
Cruises
• Rental Cars
• Hotel Reservations
• Tours

*Ftesa për ceremonitë tuaja
familjare.*



Pashko Dedvukaj

Bileta me çmime të volitshme për në Vendlindje,
Evropë dhe kudo në SHBA!

ALBAKOS

Import / Export Company

Goods ~ Food ~ Meats ~ Oil ~ Petroleum ~ Electronics ~ Equipment ~ Clothing

MADENO ASSOC., INC.

Sales • Renting • Management • Investments

• *Anywhere you go Malësia will take you there* •

Land • Sea • Air - Sales • Rentals • Mgmt. • Import/Export

Tel. 1-718-220-5000 Fax. 1-718-365-5371

www.MalesiaTours.com

e-mail: malesiatours@hotmail.com

2462 ARTHUR AVENUE, BRONX, NY 10458

Njoftim

Për reklama në gazetën
"Zani i Malsisë" dhe web-in
www.zanimalsise.com
mund të kontaktoni në numrin
tel.347-932-6629 dhe email
hotian98@gmail.com




GAZETA

Zani i Malsisë INC.

Licensohet
në SHBA me
numrin e
identifikimit
822789707



*“Brothers Taverna”, aty
ju mundësohet, cilësia dhe
korrektësia, tradita dhe
modernia, shija dhe eleganca.*



**“Brothers Taverna”,
mes shumë
mundësish, kjo
është më e mira!**



KONTAKT

Address: 23-01 Steinway Street, Astoria, NY 11105

C: (646) 584-9615

T: (718) 721-2424

T: (718) 721-2422

Web: brotherstavernanyc.com

E-mail: info@brotherstavernanyc.com

Gjithashtu, mund të na ndiqni në

Facebook dhe Instagram



“Cakor” Restaurant Bar

- Kuzhine speciale e të gjitha llojeve
- Te Cakor këndojnë këngëtarët më të mirë të të gjitha trojeve Shqiptare në Ballkan.

SHËRBEJMË EDHE ME POROSI

TELEFONO: 718-733-1033

718-733-2300

ADRESA: 632 E 186th St,

Bronx, NY 10458

WEB: www.cakorrestaurantny.com

Një mundësi,
një zgjedhje,
një zgjidhje



Korrektësi
dhe çmime të
lehtësishtme



Gëzimet tuaja
marrin dimension
të ri tek ne



NIKOLIN DODAJ



EAGLE



EYE PHOTOGRAPHY

VIDEO, PHOTOGRAPHY, EVENS

Ditëlindje, Fejesa, Dasma, Gëzime familjare, Party, Koncerte, Videoklipe, Dokumentar, etj...



KONTAKT:

NIKOLIN DODAJ

Tel: +1 (914) 338-6864

106 N WOOD AVE LINDEN, NJ 07036-7223

email: eagleeyephoto001@gmail.com

www.eagleeyephoto.com



Nga Vasel GILAJ
New York

Diaspor, apo...?!

Nje dilem e cila mund te mos kete trazuar paqen mergimtare te ndonje nacionalisti, por gjithsesi e ka kredhur ne mendime kureshtja qe te degdis pas ketij termi. Fjala Diaspor eshte fjale e lasht Greke 2500-vjecare, gjersisht perdoret qe nga shekulli XIX. Dhe qe do te thote popuj ose grupe Etnike qe e leshojn vendin e vet Tradicional, duke u vendosur ne nje vende tjeter. Pas Luftes se Dyte Boterore perdorej gurbetcinje, gurbetlinjet, e huazuar nga Turqishtja, duke u zevendesuar pase viteve 60 te shekullit XX me togfjaleshin Emigracion. Ne vitet 1990 Ibrahim Rugova nuk e ka perdorur fjalen Diaspor apo Emigrant por fjalen Mergat, Mergimtar qe vijne nga latinishtja.

Po c' fare eshte duke ndollur ne vitet

e tanishme, dhe ku kemi te bejme me dy Ministri te emruara Diaspore, dhe qe jane nje e Kosoves dhe nje e Shqiperise. Nga ku jane edhe shumica e shqiptareve te te gjithë Ballkanit. Fjala me Mergue ka dy kuptime i pari detyroj dike te ik nga Atdheu, i dyti largohem nga Atdheu per shkaqe te ndryshme Emigroj. Eshte e pranueshme te thuhet se diaspora shqiptare e posacerisht ajo e SH.B.A. nuk eshte e krijuar nga shperngulje ne grup, c'ka quhet Diaspore. Pasi ajo eshte e krijuar duke u larguar nga Atdheu dikush sot e dikush neser. Per shkaqe dhe politike duke fituar Azil, e me se shumti te vendosur ne SH.B.A e vende te tjera te botes per arsye Ekonomike. Per shembull Diaspor mund te quhen 600.000 shqiptaret qe u larguan nga Shqiperia, duke u vendosur ne Itali pas pushtimit Turke. Te tille, pra Diaspore munde te quhen edhe shqiptaret e larguare nga Kosova e vise te tjera shqiptare te Ballkanik dhe u vendosen ne Turqi. ku sot jane mese 4 milion.

Apo ata te vendosur ne Kroaci te cilet jane larguar nga atdheu si grup Etnik. Dhe me te drejt lind pyetja se a'i perfaqeson e ashtuquajtura Diaspor e SH.B.A shqiptaret e te gjithë Ballkanit, kure tani dihet se jane rreth 3 milion shqiptare qe jetojne jasht trojeve te tyre etnike. Nderkohe qe ne Sh.B.A mesohet se jetojne rreth 200.000 shqiptar. E qe munde te jene edhe me te shumt,



pasi te ardhurit nga ishe Jugosllavia jane regjistruar si Jugosllave ne baze te pasaportes qe kane disponuar.

Qe gjithsesi nuk mund ti perfaqesoj te gjithe shqiptaret, pasi tani kemi 500.000 shqiptar ne Greqi 400.000 ne Itali, e vende te tjera si Anglia Gjermania e tjer, keta te Emigruar nga Shqiperia duke e cuar numerin e te larguarve ne 1.2 milion banor. Sa u tekton atyre te Kosoves rezulton se 400.000 jane te vendosur ne Gjermani 200.000 ne Zvicer qe perbejne 60% te Emigracionit dhe qe nuk quhen Diaspore. Prandaj ne kushtet e tanishme mendojme se emertimi Diaspore ka dale jashte modes dhe jashte kohe, sepse nuk munde te themi se kemi 3. milion Diaspore, por munde te themi se kemi 3 milion Emigrant, Mergimtar apo Bashkatdhetar e tjer, e per me teper kur diaspore nuk munde te quhen ata, qe se paku nuk kan ruajtur gjuhen. Gjithsesi Ministrit tona te tanishme te emeruara te Diaspor duhet qe bejne nje studim te qarte dhe bashkohore, qe ti rezistoj kohes. Per te gjithë shqip-



taret e Ballkanit. Kure Dihet se nga 3. milion shqiptar te Ballkanit qe gjinden jashte vendit 2.8 milion prej tyre tani ndollen ne Evrope 200.000 ne SH.B.A. E me pakic edhe ne vende te tjera. Nderkohe qe ne Ballkan jetojn 5.2 milion Shqiptar nga kta 2.8 milion ne Shqiperi 1.7 milion ne Kosove 600.000 ne Maqedoni dhe 32.000 ne Malin e zi Qe do te thot

se jemi 8 milion Shqiptar aktualisht, por nese behet nje dhogaritje e thjeshte e migrimave dhe emigrimeve te her pas hershme reziltojn se aktualisht ne gjithe boten jetojn rreth 15 milion banor me prejardhje Shqiptare, dhe qe do te thote se nese do ishim ne trojet tona Ilire, shqiptaret do te perbenin shtetin me te madhe te Ballkanit.

Na ndiqni në: www.zanimalsise.com

- Ne nuk ju premtojmë lajmin e fundit, por atë që juve ju intereson më shumë.
- Ne nuk konkurojmë me askënd, por cilësia dhe përzgjedhja na dallojnë nga të tjerët.
- Tek ne, secili nga ju ka diçka për të lexuar dhe një mundësi për të treguar.

Kral Nikolla “Skënderbeu” i malësorëve

Ne kuader të vitit Gjergj Kastrioti Skenderbeu Malsoret me banim në Sh.B.A. Dhe konkretisht ata që kanë ardhur këtu, nga Trojet Shqiptare të Okupuara nga Mali i Zi, si nga Hoti, Gruda, Trieshi, Tuzi e tjer.

Me në krye Kral Nikollen e Malit të Zi, një pjesë në vitet 1876 – 1878, dhe një pjesë tjetër në vitin 1913.

Kane marrë një nisem, e cila po përflitet shumë sic është ajo për vendosjen, e shtatorës së Skenderbeut në Qender të Tuzit njëkohësisht edhe qender e komunes urbane me të njëjtin emër, ose edhe qendera e Malsoreve me banim në trojet e tyre, të Malazezizuara me se miri. Ku banojnë 16 % e banorëve të Malsisë së Madhe përfshi edhe ata, që banojnë në shtetin amë Shqipëri, të cilët si qender kanë Koplikun. Ku banojnë sipas regjistrave të gjendjes civile 60.000 banorë, ndërsa në Tuze me rrethina sipas shifrave zyrtare të Komunes së Podgorices nga ku varet edhe Komuna Urbane e Tuzit, jetojnë 8200 Shqiptarë, duke zbritur këtu nga 9600 Shqiptarë, që ka gjithsej Komuna e Podgorices 1400, që banojnë në Qytetin e Podgorices. Nderkohe që duhet përmendur fakti se në vitin 1991, në Tuze me rrethinat e tij kanë banuar 12.500 banorë shqiptarë pothuajse, që të gjithë Malsorë, ndërsa tani rezultojnë mbi 1000 Boshnjak, 500 Malazez, 700 Mysliman e tjer. Ndersa në Tuze si qender e Komunes, banojnë 4478, Shqiptarë nga këta, pothuajse 50 %

të besimit katolik dhe 50 % të besimit Mysliman. Që do të thotë se nëse u referohemi Shifrave të vitit 1991, rezultojnë se nga Tuzi, dhe zonat rreth tij, janë larguar 4300 banorë Shqiptarë – Malsorë. Të vendosur kryesisht në SH.B.A. Ku mesohet se banojnë rreth, 11.000 Malsorë pasi emigracioni, pa përmendur këtu asimilimin, ka nisur që në vitin 1960, banorët të cilët shumica deri në vitin 1990 janë regjistruar si të ardhur nga ishë Jugosllavia, bazuar në pasaportat që ata kanë disponuar. Gjithsesi përafësisht, pa e ditur saktë numërin e atyre që janë vendosur, në shtetë të ndryshme të botës. Konstatohet se nëse do të banonin në vendin e tyre, Komuna Urbane e Tuzit, tani do të kishte afërsisht 20.000 banorë. Sidoqoftë tani po kthehemi tek problemi, që duam të trajtojmë nëse duhet vendosur apo jo, shtatorje e Skenderbeut në Tuz.

Realisht kur e degjon një propozim apo kërkesë të tillë, të lindin shumë pyetje dhe enigma, historike e që të sjellin deri në ditët tona, ku me kryesorja është kjo, pak muaj më parë dhe konkretisht në Nentor të vitit 2017. Në komunën urbane të Tuzit u zhvilluan, zgjedhjet vendore për të përcaktuar drejtuesit e rinjë të kësaj komune me shumicë shqiptarë të popullsisë. Përfarë ndodhi realisht, me 11.000 persona në listën e zgjedhësve, dhe ku pjesëmarrës në votim kanë rezultuar 6.900 persona, pothuajse që të gjithë shqiptarë, pasi shqiptarë janë edhe ata, që janë Myslimanizuar,

Boshnjakizuar, e Malazezizuar. Duke bërë anti-shqiptarin, sic janë Nikoll Gega nga Trieshi që i prin Partisë së Gjokanovicit në Tuz. Fadil Kajosha nga Gruda që bën punën e Përkthyesit e jo atë të Kreut të Kuvendit të Tuzit. Halil Duković që është nga Trieshi dhe ku një orë flet shqip e një orë Malazezce, Nexhat Dreshëviq që është nga Dreshajt e Hotit cili kërkon të heq edhe gjuhën shqipe në Tuze dhe që jo pak ia ka arritur, si dhe Doktorit i Shqiptarëve të Tuzit, kreu i komunes Hotiani – Abedin Abazović. Që tani ngre flamurin Boshnjak në Tuz. Pa harruar të përmendim edhe ideatorin e shkatërrimit dhe asimilimit të banorëve të Malsisë së Madhe, në shtetin e Malit të Zi, Ferhat Dinosh, i cili pasi e ka kryer mesazhin misionin e len amanet nga Kral Nikolla, tani me telekomandë në dorë, e drejton antishqiptarin e tij, të Tuzit, her nga Tirana e her nga Prishtina. Duke bërë Tuzin si Jeruzalemin. Nuk të cudit fakti se dikush nga Diaspora Malsore kërkon që të vendoset Skenderbeu në Tuz, por të cudit fakti, se si Malsoret i dhan Partisë së Milo Gjokanović dhe koalicionit të tij qeverisë në Tuz plot 4450 vota, ndërsa atij, Shqiptarë 2450 vota. Ose aq vota sa ci patën dhen ushtar e komandant. Kral Nikollës në vitin 1912 duke sulmuar Shkodrën për t'ia aneksuar Malit të Zi, dhe që nga duart nuk ia hoqën Shqiptarët por, Austro – Hungaria. Prandaj na duket shumë absurde një kërkesë e tillë, se si mund të rri heroi ynë kombëtar, në mes tradhtarëve të kombit. Pasi vota në trojet Shqiptare kudo qofshin ata, është edhe votë për ceshtjen tonë Kombëtare. Ende të pagjidhur. Nuk e kuptojmë se si shqiptarët e Tuzit, nuk veprojnë si ata të Maqedonisë. Por i dhan koalicionit të Milo Gjokanović 20 keshilltarë, dhe atij të partive shqiptare 12 keshilltarë. Në këto kushte një nisem e tillë, as që duhet përmendur sepse busti me i mir për Skenderbeun do të ishte vota e dhen për Partinë Shqiptare, dhe përfaqësuesit e tyre në Tetor të këtij viti, e deri at'her Malsoret e kanë Skenderbeun e tyre Kral Nikollen në Podgoricë, i cili do të mbahet mend përjetësisht si pushtuesi i tokave dhe trojeve Shqiptare. Sic janë Ulqini, Tivari, Kraja, Tuzi, Plav – Gucia e shumë të tjera. E sa për propozuesit të cilët vijnë nga rradhët e Shoqatës Malsia e Vogel, dëshiroj t'u kujtoj se nuk kanë qenë

te zotet qe te sigurojne nje shesh publik ne Tuz, per vendosjen e shtatores se Dede Gjo' Lulit por e kane vendosur ne oborrin e Kishes. Ndoshta dikush prej tyre, edhe ka menduar se meqense Deda u vendos ne oborrin e Kishes, tani Skenderbeun mund ta vendosin ne oborrin e Xhamis. Gjithashtu deshiroj tu kujtoj ketyre zoter-

injeve, se si nuk shkoj asnjeri prej tyre ne Tuz gjate fushates, apo edhe ditën e votimit, ashtu si shum prej tyre ken ulltuar, nga Amerika per ne Podgorice, me bileta te paguara nga Malazezet per te festuar, shpalljen e Mali te Zi Shtet. Sic organizuan edhe festen me 25 Nentor te 2017. Te shtat

shoqatat Shqiptare te Malit te Zi ne New York, si shtat republikat e ishe Jugosllavis, duke e festuar humbjen ne Tuz nje dite perpara, pasi atje zgjedhjet jan zhvilluar, sic e tham me 26 Nentor. E kuptoj se kjo eshte vetem nje loje dhe sa per te terhequr vemendjen, nga ajo qe ka ndollur dhe po ndoll me Shqiptaret ne Malin e Zi, e ne rastin konkret me Malsoret, por nuk e kuptoj, se Skenderbeun c' ka e duan atje, sepse ai nuk lufton me, por duhet te luftojm ne, qe te realizohen, aspiratat e tij Kombetare, dhe tani c' eshte me e mira, jo me shpat, por thjesht me nje flet votimi dhe me metoda bashkohore, demokratike dhe diplomatike. Duke mos i marre ato pak para, ne kembin te votes pro Malazezeve e te tjereve. Nuk po u kerkojme te kapin pushket, as te ndahen nga Mali i Zi, por po u kerkojm qe te votojn si Shqiptar, dhe per Shqiptaret me qellim qe pushtetin, ne Atdheun e tyre, ta gezojne vet ata, dhe te mos shkombetarizohen duke i trajtuar si pakic kombetare ne trojet e tyre, stergjyshore Iliro - Shqiptare. Se paku kte duhet ta bejn te gjithë ata, qe me siguri tani ndjehen te mashtruar dhe te penduar, keshtu do ta vendosim Skenderbeun edhe ne Tuz.

Vasel Gilaj
New Jork



MONUMENTI I KRAL NIKOLLËS
I VENDOSUR NË PODGORICË

Zani i Malsisë

Cili ishte Kral Nikolla?!

Prill 2018 10

Nikolla I Petroviq – Njegosh, ka lindur me 7 Tetor 1841 dhe ka vdekur me 1 Mars 1921. i njohur si Knjaz Nikolla dhe Kral Nikolla, ishte princ i Malit të Zi, ne periudhen 1860 – 1910 dhe Mbret ne periudhen 1910 – 1918. Duke e drejtuar dhe sunduar Malin e Zi per 58 vjet me rradhe.

Trashegoi fronin nga Xhaxhai i tij. Danilo. Gjate sundimit te tij, Mali i Zi me vendim te Kongresit te Berlinit me 13 korrik te vitit 1878, pase luftes malazeze – turke, fitoi njohje nderkombetare dhe zgjerim te rendesishem teritorial. Kryesisht me troje dhe popullsi shqiptare. Zgjerim te metejshe Mali i Zi fitoi edhe ne vitet 1912 – 1913 pase luftes Ballkanike. Ai ka qene nje mbeshletes shume i madhe i Serbeve, duke kerkuar her pas here

bashkimin e Serbeve dhe Sllaveve. Kral Nikolla ishte nje armik i betuar i Karagjorgjeviqeve, ndoshta sepse ata ishin me origjin Shqiptare dhe konkretisht nga Kelmendi.

Ne Luften e Pare Botrore i shpalli luften Austro – Hungaris. Mbretaria Malazeze fillimisht u rezistoi sulmeve Austro – Hungareze por u dorzua ne janar te vitit 1916. Mbreti Nikolla, se bashku me qeverin e tij dhe oborrin mbretoror u srehua ne France, ne egzil, nga i cili kurre nuk u kthye me.

Mbreti Nikoll vdiq i izoluar ne mergim ne France dhe u varros ne nje kishë Ruse ne Sanremo ne Itali.

Eshterat e tij, dhe te bashkeshortes Milena Petroviq, me te cilen kishte 9 femij, nga te cilet 6 vajza dhe 3 djem. Ne vitin

1989 u kthyen ne Malin e Zi, dhe jan rivarrosur ne Cetin ne kishen mbretetore ne Qipur.

Me ceremoni shume nderuese. Shtatorja e tij eshte vendosur hipur mbi Kale, ne qender te Qytetit te Podgorices. Kral Nikolla ishte edhe shkrimtar, pese nga gjashte vajzat e tij, kan qene te martuara me Princer dhe Mbretet te vendeve te ndryshme te Evropes, c' ka ka bere qe Kral Nikolla te thirret edhe "Vjehri i Evropes". Kral Nikolla do te mbetet ne histori edhe per marrdheniet, qe ka pasur me Shqiptaret, e posacerisht me Malsoret mjaft prej te cileve, edhe i ka bler e mashtruar, e joshur me pushtet vecanarisht gjate rrethimit te Shkodres per gjashtye muaj me rradhe, nga Tetori i vitit 1912 e deri ne Prill te vitit 1913, me qellim qe te merrte Shkodren, pa te cilen ai thoshte se Mali i Zi nuk mund te jetoj. Duke thirrur O Namu O Namu – Andej Andej.

"Zani i Malsise"

E PAVARUR, INFORMATIVE, HISTORIKE DHE PATRIOTIKE

Kur Austro-Hungaria detyron Knjazin të lëshojë Shkodrën

Gazetari dhe studiuesi Armand Plaka ka publikuar sërish një risi në faqen e tij personale në 'FB'. Këtë radhë bëhet fjalë për një karikaturë të sjellë në vëmendje për publikun shqiptar për herë të parë, ndërsa ajo mban datën 11 maj 1913, kur Shkodra sapo ishte çliruar nga malazezët, falë ndërhyrjes së fortë e të paekuivoke të Austro-Hungarisë. Karikatura mbart dëfturën: Nikolla: Nga firmat kam frikë, kështu që më mirë po e dorëzoj sërish mbrapsht orën, që ma dhuroi Zoti im, atje ku e mora! – dhe na jep të kuptojmë në mënyrë shumë artistike dhe humoristike një moment të historisë sonë kombëtare, nga e cila, nëse do kish ndodhur ndryshe, sot Shkodra nuk do ishte një qytet shqiptar. "Në fakt satira politike, në një kohë kur nuk kishte as radio e televizion, ishte shumë e përhapur në atë kohë dhe problemet e Ballkanit papritur po zinin titujt kryesorë të gazetave e revistave të ilustruara austro-hungareze. Shqipëria zinte jo pak vend ndër to, ndërsa Shkodra e pushtuar nga malazezët po përjetonte ditët e saj të tmerit. Por, pas stuhisë, fati e desh që ajo të mbetej sërish shqiptare, falë ndërhyrjes së fortë e të vendosur të Austro-Hungarisë, ultimatumi i së cilës bëri që Knjaz Nikolla t'ua kthente sërish qytetin të zotëve të shtëpisë. Në këtë kuadër, është bërë edhe kjo karikaturë, e cila vjen për herë të parë pas më shumë se 100 vjetësh



Te paret e Kelmendit erdhen nga Trieshi

Gojdhenat krijojne bindjen dhe qartesojne se ky fis e mori emrin nga i pari, i quajtur Kelmeca. Prinderit i kishin banuar diku ne Drekal te Kucit. Vdekja i mori, por lane nje djale te vogel. Shtegtoi dhe u be rroghtar ne Bekaj te Trieshit. Emri i tij i vertete ishte Ahmat. i urte, i pashem aq sa i nderruan emrin per ta thirrur me perkedheli "Kelmeco". Ne shtepin ku u pajtua rroghtar jetonte nje vajze me emrin Bumce. Cdo dite kullotnin delet se bashku. Kaluan ca vite. Vajza qe kishte hedhur shtat si zane mali ra ne dashuri me Kelmecin. E frenonte zemra e rroghtarit nevojtare per te kuptuar ndjenjat e saj qe te merrte guximin t'i shfaqte ate qe ndjente per te. Erdhi nje dite qe Bumcja ta mundte ndrojtjen. Urte e bute mori guximin t'i shfaqte dashurin e fshehur ne zemren e cilter te saj dhe i thote Kelmeco, je prej mishi apo prej guri? Je njeri apo je engjell? S'e kupton qe une po shkrihem per ty?

I befasuar, por edhe i dehur nga dashuria, sic ngjet kure linde mes dy te rinjeve, iu pergjigj. Lum vajza, nuk jam as prej gurit, as nuk jam engjell. Mish e gjak te riu kam. Por nje gje dua te ta them, yt ate me jep buken, me ka besue e mbajt si rob te vetin. Ndera nuk dhunohet. Ta bejme me mend kete pune. Me kete dua te them se, nese vertete me do e kerkon te mos ndahemi kurre nga njeri - tjetri, te ndajme gezimet e hidherimet bashke, te krijojme jeten si gjithnje te martuarit, mbushja mendjen tyt eti dhe, nese i len ne zemer atij une te marr per grua. Bumcja me zgjuarsi, takt dhe durim beri te gjitha perpjekjet derisa ia mbushi mendjen te atit. Mori bekimin e tij dhe u martua me Kelmecin. Cuditerisht, me te marre vesh ngjarjen, fisi reagoi





E PAVARUR, INFORMATIVE, HISTORIKE DHE PATRIOTIKE

ashper, duke mos u pajtuar me faktin se si nje Bekaj ia dha te bijen nje jetimi pa plang e pa shtepi?!.... Kanuni e perzuri. Nje i huaj sipas tyre, s' mund te vllazerohej me ta. U detyruan te blejne nje "bisht" mali ndermjet Tamares e Grabomit qe u thirr Bishtan. Me vone Peshtan. Perendia vuri doren ne zemer. U fali shtate djem. Tre vdiqen kerthinje ku u jan harruar edhe emrat. Kater u bene burra. Quheshin Seli, Nili, Vuli, e i fundit Voli... Nga keta te katert u krijuan bajraket e Selces, Nikcit, Vuklit e Boges te pagezuar se bashku me emrin e te parit, Kelmend. Vjen casti i padeshirueshem, por edhe i pashmangshem qe Kelmeci te semurej rende sa te mos munde te ngrihej me nga shtrati. Therret te kater djemte. E nisi me fjalet se po u le fukara pa pasuri e gje ne dere.

U kujtoi te shkuaren e tij kure ishte pasuruar duke punuar si coban, mjeshter gedhenes guresh e derrasash, por edhe per udhtimet qe kishte ber si pasanik hipur

mbi kalin me shale. Dhe per te dale, sa pa humbur kohe, aty ku kishte dashur, shtoi. Ne kujtim te atyre koheve kam ruajtur sic i shihni vjerrur ne mur. Kerraben, Shalen, Lahuten dhe Spaten. I pari Seli per t'i dhene force e zemer te atit u cue e mori krraben e iu drejtua Do te shoh dite te mira me kete krrabe, or babe, qe do te thote zgjollti cobanin bagtine. Ia priti Nili me shalen kapur ne dore, i tha Si lum baba do te udhtoj mbi shpin te kalit te shales.

Sa per mue thote Vuli, mos ki pike meraku babe. Po s'mujta ndryshe, me rrena e kacarra kam me dale diku ne breg. I ati e nderpreu Po ti Velo, c'mjeshtri po merr? Po marr lahuten babe qe te behem mjeshter si ti!

Tashma pa merak se djemt s' po e leshojshin veten, i ati u thote Zoti ua prift mbar, o djemt e mi ne rriskun qe ai i lumi u ka shenuel. Djemt u rriten. U martuan. Bijte e Kelmecit paten shume djem e vajza.

Bishtani ishte teper i ngushte per jetese.

Filloi konflikti me vendasit kufitare qe ishin banues ne keto vise para Kelmecit. Kufitaret e atyre luginave ishin te bute dhe pasardhesit e Kelmecit i quanin "Qyqare" Qeveriseshin nga nje kryetar. Te merzitur e te revoltuar nga mbrapshtite e nipave te Kelmecit, u mblodhen ne kuvend per te percaktuar rrugen qe duhej te ndiqnin ne fisin e ri te Kelmecit.

Kryetari ishte i ndjeshem, i urte dhe i keshillon njerezit e tij qe, perpara se te ngaterroheshin, te benin nje prove. Dhe u thote. Po u bejme nje rreng. I therrasim per dreke dhe, pasi te lajne duart, po u shtrojme sofran ne funde te odes ku do te hane buke. Po qe se keta aviten si qyqare ne sofer dhe hane pa u ndigjue, do te thote se na e kane friken. Ne do te rrimen serbes. Po bene fjale dhe nuk e hane buken e marres, ta dini se jane me te forte se ne. Atehere duhet me leshue. E pane te arsyeshem mendimin e kryetarit, dhe vendosen me veprue si tha ai. Por nje djale vendas qe ishte probatin



ne mezdite. Nese nuk kthehej te mos e prisnin e te vazhdonin rrugen, sepse ai s'do te ishte me gjalle. Me te vendosi te kthehej edhe nje i squt

Sipas fjales, vellezerit priten deri ne kohen e caktuar. Kure e pan se s'po vinin, i pari i vellezerve, duke dyshuar, mallkon me keto fjale. Ne kjo fsh mbete diku more vella, u pafshim ne ate jete, por ne kjo fsh gjalle, mbi tri shtepi mos shkofsh!

Ka shume vite qe ky fise eshte zhvendosur ne Kodra Reke te Ishmit ne famullin e Bizes. Keta jane shtepia e Mirash Preles e ne kufi me ta edhe squtet, te cilet thuhet se e moren emrin nga kjo ndolli

Kohe me pare, ne mesjeten e hershme, nje shqiponje ne Kelmend ishte mesuar t'u leshohej si vetetima njerezve e t'i cukiste ne maje te kokes. Pastaj u hante trute. Djaloshi qe dallohej per trimeri, nje dite vuri nje kaki (sac) ne koke. Ne dore mbante nje shpate te mprehte. Shqiponja, sa e dikton, i leshohet mbi koke. Djali e pret me kaki dhe me shpate e ndan shqiponjen me dysh. Qe atehere fisit te tyre u mbeti emri squt (seatum). Pasi mbetet vendi shkrete, fisi I Kelmendit ndahet ne dy lagje qe nji-

hen me emrin lagje e Kelmendit. Seli me Probatinin zune vend ne katundin qe mori emrin Selce. Nili ne Nikc, Vuli me Volin ne Vuklin e sotem. Nuk kalon shume kohe e Seli me Probatinin shkojne tek Vuli. Marrin dhe kete me vete Volin dhe shkojne me bujte tek Nili. Te nesermen marrin zagaret per gjah. U bie ne sy nje lugine e bukur. Duke e pare se Volit po i pelqente, u leshuan si te terbuar mbi banoret e atij vendi, te cilet u frikesuan dhe iken. Ky vend i mbeti Volit. Qe atehere e mori emrin Bogna. Ne perkujtim te te parit te tyre te kater vellezerit e lane Beshtanin te pandare. Qe atehere e deri me sot ky vend u perkiste bajraktareve te Kelmendit. Persa u perket anasve, qe ishin autokton, ka mendime se kur u larguan moren Qafen e Godise dhe u vendosen ne Kosove. Duket se ikja e tyre rrjedh nga rritja e numerit te kelmendaseve qe gjenden ne ate krahine. Por ata nuk e pranojne se jane anas, por kelmendasit e vendosur me vone ne ato vise. Edhe sot keta e tregojne bajrakun e vellazerise se tyre me Kelmendin (kryesisht me Nikcin dhe krenohen me fisin e vet).

NIKOLLE SHYTI

me Selin e njoften kete per ate vendim qe kishin marre. Seli njofton menjeher fisin e vete. Dreka pergatitej dhe vijne perfaqesuesit e fisit te Kelmecit. Filluan te vendosen ne Sofer, andej nga fundi, sic ishte planifikuar. Por, pa u ulur, filluan te shkelmojne sofren, e permbysin dhe dalin nga shtepia te zemeruar, duke thene Malet e kane zakon me e nderua mikun ne krye te vendit, por ju nuk dini se c' eshte burreria. Kesaj pune keni me ja pa sherrin Te frikesuar nga ky kercenim, vendasit u detyruan te lene vendin, duke marre poshte per ne Leqet e Hotit, per te gjetur vende tjeter per te jetuar. Probatini i Selit, kur doli ne Rapshe filloi te pendohej e s' donte te largohej nga vendi i tij. i genjen vllazerit duke u thene se ishte i detyruar te kthehej ne katund pasi atje kishte harruar zagaret. U munduan vllazerit qe t'ia kthenin mendjen, por ai nguli kembe ne te veten. Porositi ta prisnin deri te nesermen



Kelmendasit në luftë për liri dhe identitet



Nga Ndue BACAJ

Ne panteonin e lavdishem të luftërave e perpjekjeve shumshkullore të shqiptareve kudo në trojet e veta etnike, në roje të lirise e pamvaresise, një vend të Dukshem e të lakmueshem kanë padyshim edhe Kelmendasit, fisi ose me sakt Kryefisi i fiseve Iliro – Shqiptare. Kelmendasit ishin pjese e pandare e luftërave mbrojtese të Mbretërisë Ilire që me fillimin e betejave të para kundër invazioneve Romake. Mjerisht këto luftera të fituara dhe të humbura i ka mbuluar pluhuri i harreses 2000 vjecare, dhe nga ato kohe në nuk jemi në gjendje të sigurojmë një material kronologjik të betejave të Kelmendaseve në vecanti. Gjithsesi një gjë është e sigurt, se Kelmendasit si gjithë Iliret e tjere ishin pjese e pandare e kryengritësve që nuk i donin Romaket të sundonin mbi trojet e tyre. Por dalngadal u bene edhe pjes e rendesishme e perandorise Romake, kur ajo po humbte sensin pushtues e po fitonte ate bashjetues. Me vone kure turmat Sllave filluan të zbrisnin në treva të Ballkanit, dhe në pjes të Ilirise në shekullun VI-te, trojet e kelmendit i “preken” vetem në shekullin X-XI pas lindjes së Krishtit. Kelmendasit kanë një histori të dhimbshme, por të vetdijshme në luftërat mbrojtese ndaj Sllaveve të Zetes

dhe Nemajes në vitin 1198. Gjithashtu beteja të pafundme zhvilluan Kelmendasit në vitet e pushtimeve të Mbretërisë së Stefan Dushanit 1331-1335, Pas shëbjes së kësaj mbretërie Kelmendi u bë pjesë e

ishin e vetmja kështjelle e pamposhtur. Madje Kelmendasit kanë një rol mjaftë të madh edhe gjatë 25 viteve të lavdishme të Races sone, që me në krye kryeheroin tone të qyteterimit Evropian Gjergj Kastri-



Principates Shqiptare të Balshajve e cila ndërtoi konturet e një shteti që përfshinte shumicën e teritoreve Etnike Shqiptare. Në vitin 1389, në aleancën Nderballkanike Antiturke, morri pjesë edhe fisi i Kelmendit. Në betejën e tmerrshme të këtij viti në Fushe-Kosovë, përveç shumë luftëtarëve të tjerë nga viset Ballkanike e Shqiptare. Merrnin pjesë edhe dhjetra luftëtarë Kelmendas, pas vitit 1389, kure aleanca anti-turke humbi Kelmendasit

otin, Skenderbeun frenuan hegjemoninë e një race tjetër, që rrezikonte të ndryshonte Evropën, në vitet 1443-1468. Në gojedhenat e vendaseve Kelmendas edhe sot flitet se pas vdekjes së Skenderbeut më 1468 mbesa e Skenderbeut u strehua në Selcë të Kelmendit, për të shpëtuar nga pushtuesit turqë që e ndiqnin. Natyrisht që shpëtoi pasi kelmendi nuk u pushtua, kure u pushtuan treva e tjera të Shkodrës, Malsisë e Shqiptarisë në vitin 1479 por në

vitin 1497. E kjo qedrese rreth 18 vjecare e Kelmendaseve ndaj fuqive te medha ushtarake te kohes spjegohet jo vetem me trimerin e ketyre burrave, jo vetem me terrenin e mbrojtur, por me siguri edhe me ndihmen e vete besimit te tyre Kristian qe i perkiste krejt Kelmendi.

Ne vitin 1509 Perandoria Osmane kerkoj harac shtese per cdo shtepi, me justifikimin per te rindertuar Stambollin e demtuar nga termeti. Malsoret e Malsise se Madhe me ne krye Kelmendin nuk pranuan kete takse, qe qeveria turke kerkoj ta marrin me force e ushtri, por qendresa e Malsoreve, se bashku edhe me Malin e Zi detyroi Sanxhakbeun e Shkodres te terheq ushtrin dhe per rreth vite Malsoret nuk e paguan asnjeharacin. Ne vitin 1603 perseri Kelmendasit ishin ne krye te kryengritjes antiturke e cila zgjati deri ne vitin 1609, dhe si aleat Kelmendasit ne keto Kryengritje kishin Kucasit, Piperet, asokohe Shqiptar si dhe Dukagjinasit. Eshte interresant nje njoftim i 12 shtatorit 1608 i Francesk Skoroveut cili informonte Venedikun se sic thuhet ne Kelmend e Dukagjin prodhohet Barot e arkibugja nje dhoj arme luftimi e kohes. Ne vitin 1612 Malsoret dhe Kelmendasit zhvilluan nje lufte tre mujore me forcat Osmane qe kapnin shifren rreth 25.000 ushtar dhe ishin vendosur ne Podgorice. Ne vitin 1613 perseri Kelmendasit i bene balle nje ekspedite ndeshkuese prej 15.000 forcash Turke te komanduara nga Asllan Pasha. Luftimet zgjaten 12 dite por pa sukses per forcat turke qe nuk munden te asgjesojne Kryengritesit e Kelmendit. Si "kunderpergjigje" gjate terheqjes forcat turke shkatrruan fshataret dhe muaren rob rreth 80 gra e femije te pafajshem, duke deshmuar edhe nje here mizorit e pashoqe te ketyre djajeve qe u kishin "rene" ne "hise" Shqiptareve. Kelmendasit muaren pjese ne dy kuvendet Ndeballkanike te 15 korrikut dhe 8 shtatorit te vitit 1614, ne mes te 44 emrave te perfaqesueseve te ndryshem figurojne edhe emrat e Vojvodes se Kelmendit Vuk Keqi, dhe Vojvodes se Boges Gjeke Culi.

Pase ketyre Kuvendeve kelmendi dergoi ne kete aleance antiturke rreth 650 luftetar. Interresant eshte numeri i ushtareve qe i atribuon Kelmendit M. Bolica qe shkruan per nje shifer prej 5830 Luftetaresh.

Perseri ne vitin 1616 ne kuvendin Nder-



KRYQ NË SELCË, PUNUAR NGA GDHENDËSI, PJETËR VUKAJ

ballkanik te Prokupjes, por edhe ate te Belgradit – Beogradit te nentorit te vitit 1620, Kelmendasit jane pjesmarres dhe aktiv. Dokumentin e beses se lidhur ne Belgrad e nenshkroi perseri Vuke Keqi ne emer te Kelmendit. Me 15 shtator 1621, figura e njohur e kohes per Shqiptarizem Pjeter Bogdani prift katolik relatonte. “Kelmendasit burra te vlefshem dhe njerëz te vendosur, qe kurre nuk ka mundur turku me i zotnue, as me marr prej tyne haracin. Ata rrine vazhdimisht me arme ne dore, qenderojne prhere pothusjse ne kryengritje kunder turkut, me deshir qe te njohin nje dite Clirimin e vete”.

Nje flet e “Historise se Shqiperise” e botuar ne Shkoder ne vitin 1917 shkruan per vitin 1623, se Kelmendasit bashke me Kucasit ishin ne krah te Malit te Zi ne lufte kundre turqeve, te cileve u dolen para afer Podgorices dhe i shpartadhuan, ku per 15

vjet mrapa, nuk u pane me ne ato vende. Me 1638 nga Bosnja u nise ne drejtim te Kelmendit Vuco Pasha me 15.000 forca . Pasi u la qe kjo ushtri te hynte deri ne lugin u godit ne befasi, dhe pas 16 diteve luftime, ushtria turke terhiqet me turp pasi kishte lene ne fushen e betejes me mijera ushtar. Per kete trimeri te Kelmendaseve Frang Bardhi ne qershor te vitit 1638 relatton “ Jane shume te eger prej natyre dhe shume te guximshem ne mjeshterin ushtarake, te pashem dhe trupmedhenje”. Po nga ky relator mesojme se Pashai humbi ne kete lufte 9 Sanxhakbej dhe pashadharet Halil dhe Nahun Pashen, ndersa vete Vuco Pasha arriti te ike ne Shkoder.

Ne vitin 1649 per tre dite luftime pushtuan keshtjedhen e Medunit. Ne vitin 1684 perseri Kelmendasit ishin pushke e ngrehur kunder turqve. Pjeter Bogdani, prifti katolik qe simbolizonte Fe e Atdhe i dergoi nje

relacion Romes ku nder te tjera shkruan “Kelmendi eshte nje Keshtjelle natyrore, me nje popullsi monolite nga tri pikpamje, banoret e tij jane te gjithë shqiptar, te gjithë katolik, dhe te gjyhe luftetare”.

Me 1686 Kelmendasit pengojne Sulejman Pashen me ushtri te kalonte ne veri te Tivarit. Me 1688 ndihmuan Kucasit te thyejne Sulejman Pashen ne Medun. Nga viti 1689 hyne ne Prizren e Shkup Kelmendasit se bashku me Austriaket. Rolin kryesor ne keto luftime e luajten Kelmendasit.

Pjeter Bogdani ne ate kohe i quante Palci i Shqiptareve Katolik. Ne vitin 1691 kur turqit mesyne per te ndeshkuar Malsin e Madhe, por edhe ne vitin 1692 kur turqit iu turren Malit te Zi Kelmendasit ishin ne balle te luftimeve e te rezistences.

Ne vitin 1700 Otomanet detyruan te shperngulen me force nga kelmendi rreth 200 familje, si qellim i dobesimit ne forca ush-



tarake, disa prej te cilave edhe u rikthyen ne vitin 1707. Ne luftimet e viteve 1700 u dalluan si gjithnje te gjithe luftetaret kelmendas. Luftime te cilat perjetojne Heroinen e perjetshme te Kelmendit e Shqiperise Noren, e perjetsuar me emrin Nora e Kelmendit. e bija e Vok Marash Ucit e cila vrau ne cadren e tij Pashain Turk, duke lene pa komandat nje ushtri prej 30.000 vetesh, nga e cila vetem ne kelmend mbeten me mijera te vrare.

Interresant eshte relacioni i arkitektit te kuvendit te Arberit te vitit 1703. Viceno Zmajevikut, Zmajeviqit ishe Kryeipeshgjev i Tivarit i cili me 31 gusht 1707 i shkruante Romes , per rastin e Nores se Kelmendit " Di se midis kelmendaseve u duken ne betej 300 gra, te armatosura me cdo gje, kurse njera prej tyre pati nderin ta vras e ti pres koken , turkut komandant te ushtrise se vendosur. Edhe Arberia prodhon Amazona. Ky nuk eshte shembulli i pare e trimeror i grave kelmendase, sepse edhe njeher tjeter vetem me gure ato i dhane dermen ushtrise se Vuci Pashes, qe pati 500 te vdekur te cilet mbeten te varrosur nen gure". Ne vitet 1737-1739 kelmendasit dallohen ne luften e perbashket me Malsoret



e Malsise se Madhe dhe Austriaket per te cliruar nga Turqit Nishin e Novipazarin. Kelmendasit u shquan ne lufterat e tyre ne krah te Bushatllinjeve te Shkodres ne vitet 1775-1829. sa her keta ngriten krye kunder stambollit, kjo lufte e kelmendaseve konstatonte ne mbylljen e rrugeve per forcat e Valiut te Bosnjes qe kerkonin te shkonin ne Shkoder per te shtypur forcat "Rebele". Te Bushatllinjeve.

Vlen te theksohet nje akte pabesie i Bushatllinjeve qe kishin marre shume vese te turqelive, qe per interesat e tyre i tradhtonin vllazerit Shqiptar Kelmendas. Pikerisht ne vitin 1806 nje formacion i Bushtllinjeve te Shkodres kishte marre tinze detyren e stambollit per te shtypur nje kryengritje te ndezur ne Kelmend, ku pase nje tradhtie, kundershimin e Malsoreve e kthyen ne hakmarrje duke varur ne Tamare gjashte drejtues kelmendas, sipas huqit turke. Gjithsesi kelmendasit kundershitua n reformen e Tanzimatit me arme ne dore, duke e bere kelmendin nje kala ku ligjet e osmaneve ose kalonin shume veshtire, ose gjenin vdekjen duke u perplasur me muret e pamposhtura te kelmendit. Vitet 1845-1847 e vecanarishte viti 1857 ishin vitet qe i hoqen gradat e lavdishme Mehmet Ali Pashes i njohur si Maxhar Pasha. Kelmendasit ishin pjes-

marres ne te gjitha kushtimet qe Malsore e Shqiptar leshonin ne mbrojtje te tokave shqiptare, te tilla ishin lufterat mborjtese te Vranines me 1862 te mberojtjes se Ker-





UC TURKU

rnices po me 1862 e trojeve te tjera deri ne vitin 1878 kur ne Prizeren u zhvillua kuvendi me i madh mbare kombetar qe njihet me emrin Historik Lidhja e Prizerenit. Ne kete kuvend nga kelmendi mori pjese trimi Ujk Gila i Selces. Nder 56 anetaret e Keshillit te pergjithshem qe perfaqsonin te gjitha Besimet dhe krahinat ne Komitetin e Lidhjes u zgjodhe edhe Bajraktari i Kelmendit Ujk Gila. Ne mbrojtje te cdo pellembe toke shqiptare, Kelmendasit ishin shpate e gjalle e Malsise e Shqiptarise, duke bere te pavlefshme edhe vendimet famkeqe te Kongresit te Berlinit te vitit 1878. Ne mberojtje te Plaves e Gucise ne luften e vitit 1879 kunder ushtrive Malazeze te komanduara nga Vojvoda fame-madh Mark Milani, Kelmendasit muaren pjese me 300 luftetare. Te komanduar nga trimi Nik Leka.

Ne protesten e marsit 1880 qe kreret e maleve te Malsise u drejtojne Fuqive te Medha te Evropes, kane emerat dhe nenshkrimet e tyre. Kacel Turku, Ded Gjonaj, Mark, Gjoku, Mik Micali, dhe Nikoll Mirashi. Me 18 prill 1880 ambasadoret e fuqive te medha vendosen qe ne vend te Plav-Gucis

Malit te Zi ti jepnin Hotin dhe Gruden. Ne mbrojtje te ktyre trojeve Kelmendi dergoi 400 luftetare, te cilet u perqenderuan ne Dinosh. Ne krye te tyre si gjithnje ishin Ujk Gila e Nik Leka.

Me 27 qershor te vitit 1880 fuqit e medha evropiane vendosen te nderrojn Hotin e Gruden me Ulqinin, pasi trimat malsore nuk e kishin lejuar kurre ushtrin malazeze ti pushtonte kto troje shqiptare.

Malsoret dhe Shkodranet menjeher u organizuan te mbronin Ulqinin e trojet e tjera per rreth, dhe tashme ata nuk luftonin vetem perballe ushtrive malazeze, por edhe perballe ushtrive te medha turke. Lufta ishte e tmerrshme dhe e gjate deri at'her kure Evropa u shpall "fituese" duke i leshuar me 27 nentor te vitit 1880 Malit te Zi kete treve brilante te Historise se Shqiperise sic eshte Ulqini.



NIKË LEKË PEPAJ



PREKË GJELOSHI

Kelmendasit si gjithnje u dalluan per trimeri dhe patriotizem te pa shoq por mjerisht Evropa dhe Turqia ishin me te fuqishme dhe u be si deshten ata. Gjithsesi Malsoret e Kelmendit u detyruante leshojne troje, por jo zemren dhe deshiren per liri dhe identitet. Me 1908 luftuan heroikisht 20 Selian me 300 malazez. Dallohen trimat Marash Gjeka, Martin Smajli, Luc Ujk Leka, Marash Loshku, Mirash Shyta, Marash Ujka dhe Len Dedja. Po keshtu Kelmendasit luftuan e qenderuan edhe gjat viteve 1908-1909-1910. Ne kryengritjene flamurit te vitit 1911 kelmendasit si gjithnje u gjinden ne balle sapo krisi pushka per liri. Nga te gjitha kto beteja qe moren pjese kelmendasit me e ashpra cilesohet ajo e 25 prillit 1911 ne Suken e Mkushit ku 1000 luftetare Kelmendas shpartadhuan me heroizem Et'hem Pashen me ushtrin qe komandonte. Kelmendasit i komandonte kryeipari Luc Mark Gjeloshi, beteja zgjati 6 ore duke i shkaktuar armikut 150 te vrare, por edhe nga kelmendasit mbeten ne beteje trimat Vllezerit Gjeke e Zef Prek Mark Leka. Pjeter Mark Rudi, Nik Marashi, Ujk Hoti dhe Mark Preke Marku, si dhe u plagosen disa te tjere. Vlen te permendet se gjate ketyre luftimeve Kelmendesja Gjelin

Gjokja mblodhi 52 pushke. Memorandumi i krereve Shqiptare që u nënshkrua me 23 qershor të vitit 1911 në Grec të Selces jo vetëm që i zhvilloi punimet në Kelmendë, por kishte edhe nënshkrimin e Cal Dedit të Selces, Lul Rapukes së Vuklit, dhe Llesh Gjergjit të Nikcit. Kelmendaseve dhe Malsoreve iu deshe të perballen me armiqtë e tyre edhe gjatë vitit 1912 sic ishin ata Turqet e Malazetë e ku përveç pushkes Malazetë përdoren edhe hilet e dredhit. Vlen të theksohet forca morale e kelmendaseve Uç Turku, Dede Coku, Fran Pali, e Prek Cali që nuk u joshën për parave Malazetë, në këmbim të Vermoshtit. Kelmendasit u gjenden në balle të luftës në mbrojtje të tokave të tyre edhe gjatë vitit 1913. E vecanarisht në vitin 1915

Kure Mali i Zi kerkonte të zbatonte Traktatin e fshehtë të Londrës, po të 1915. Në vijim të qëndresës së Kelmendaseve për trojet e veta vlen të shenohet Memorandumi i 26 majit të vitit 1913 që dërgohet autoriteteve Britanike në Londër të cilin e nënshkruajnë. Kol Nika, Gjon Neli, Prek Groshi, Gjergj Preci, Luk Nika, Gjeto Deda, Prek Zuri, Baza Doshi, Prek Shtjefni, Luc Ujka, Tom Gjoni, Prel Toma, Kol Preci, Marash Vata, Pjeter Noka, Tom Prela, Pashko Elezi, Mark Kola, Mark Ujka, Pjeter Deda, Zef Pjetri, dhe Zef Gjoni. Nuk duhet lënë pa përmendur luftëtarin Memi i Smailit, tmerri i Malazetëve, Prel Memen Dragonin e Pathyeshem, Gjek Mark Gjelošin me tre djemtë e Noke Gjeloshit Can Lucen, Gjek Ujk Gilen e mbi të gjitha Noren e re të Kelmendit Rose Marken nga Vukli që vrau Malazetin Fil Boj, për të marrë gjakun e vëllait që ia kishin vra. Trimerin e Kelmendit e provuan edhe Austriaket që deshën të pushkatojnë Kelmendin, ku vlen të shenohet beteja e 17 tetorit 1918 në Qaf të Predelecit dhe Gropa të Selces, ku Kelmendasit zunë 700 ushtar rober, në mesin e të cilëve edhe 17 oficer. Austro-Hungarez. Kelmendasit ishin në këmbë në mbrojtje të lirisë edhe gjatë vitet 1919-1920, por edhe në ruajtjen e trojeve të tyre teper të lakmueshme nga fqinjët Serbo-Malazetë. Në vitin 1920, 17 dhjetor Shqipëria u pranua antare e Lidhjes së Kombeve, me 9 nëntor 1921 ju njoh pavarësia në kufite të vitit 1913, por ceshtja e kufirit të Vermoshtit ende e pazgjidhur. Deri më 26 korrik 1926 që u nënshkrua protokollin e Firences i para-

caktuar në konferencën e ambasadoreve të Prillit 1925. Ku Vermoshi u ndërrua me Shen Naumin. Gjithsesi Kelmendasit e mbrojtën deri në fundë Vermoshtin e tyre me në krye Prek Calin. Gjatë luftës së dytë botërore Kelmendasit u gjenden nën pushtetin e Koalicionit fashist Italo-Gjerman. Sidoqoftë interesante është "enderra" e bashkimit të trojeve etnike që Italianët e instaluar në Selcë e shpallën më 23 prill 1941,

ku Kelmendi u bashkua me Plav-Gucin. Por kjo enderr mori fundë në vitin 1943 kur edhe kapitulloi Italia. Kelmendasit ishin ndër të parët që kapën pushkët edhe kundër regjimit komunist që u instalua në Shqipëri në vitin 1945. Regjim që zgjati afro 50 vite konkretisht deri në vitin 1990, vite të cilat nga Kelmendi regjimi komunist vrau dhe Pushkatoi 86 persona, ndërkohe që ka internuar e burgosur qindra të tjerë.



Çun Lajçi, ushhtima e kijametshme e një kushtrimi hovesh kryengritëse

Nga Albert Vataj

Ate e kam njohun si një prej atyne figurave ma t'veçme të artit skenik shqiptar. Epika e këtij burri asht n'përngjasim me at t'Eposit t'Kreshnikve. Gjithçka në jetën e tij asht një përpjekje e epërme kumtimi. Por ajo t'cillën e shoh si ma përfaqësuesen e tan njasaj galerie sublime krijimi t'Çun Lajçit asht poezia. Unë besoj, ka kumtue poeti dhe kritiku, Joan

Paulhan, se ligjërimi poetik përban çelsin e tan problemeve qi na shqetsojnë. Asht ky përkufizim qi e grish penën e aktorit, për me u mundu me lshu ndër ne një za gojimi poetik, si form çlirimi, por ma s'shumti si nevoj për me reagu, me kryengrit përmbi tan'njiket përulsi e gjunzjim, dakordsi fatkeqe e apati mjeruse.

Çun Lajçi asht një ndër miqt e mi n'Facebook. E kam ndjekun, ndoshta ma shum' se ai m'ka begenis mue. Kjo s'ka kurrnji

grim randsi. Gjithqysh m'ka nguc me i shkru dy radhë për krijimtarinë e tij. Për poezinë, njat qi kam mujt me përcjell n'postimet qi m'kandin e m'bushin me zjarm sa herë qi n'te ndeshem. Akti i kijimit e lidh ate me një shumësi t'admirushme kumtimesh, t'cillat gjithashtu marrin për shum' nalt dhe mëtojnë një shpirt t'pasun dhe etje t'ethshme për dritë e diell, mirësi e mirënjohje, dliresi e përkorje.

Poezia e tij, pa nal te shqyrtimi hijerand ak-





ademik, e trajtesa analize e tekstit, asht e tjetërlojtë ngase bujarisht Zoti na ka shpërbly me shpirtna t'pasun, e këndues t'zellshëm, qi s'prajn n'Facebook e n'botime t'pangishme qi e pasunojnë letërsin shqipe dhe e gostitin t'përditshmen tonë me shkëlqim yjesh zjarmëtar.

E kam lexue e ndi bash fort e thellë, poetikën e Çun Lajçit, tragjiken dhe kushtruesen e vargut të tij, gjëmuesen dhe kënduesen e njetij krahnori, gjoksi qi e lshon vedin n'ligjërim, si shqipja kur shgjet lshohet prej krepit n'pren e vet.

Përmes poezisë s'Çun Lajçit, kam mujt me ushqy ma shumë se tamlin e një amëlcimi për gegnishten e tij, me përpush zjarmin e një dëshirimi frelëshuar, për me i'u dhan zanit e mos me hesht, siç ai ban pa drasht, se ka me nguc ndokend, e ka me turfullue ndoj mraz e inat t'dikujt, qi e liga s'din me ndal n'teposhten e ndërkryme.

Ka shumë, po bash shumë' pena e mëndje qi na gostitin zashëm gjokset e tyne, por



Çun Lajçi, tue zgjedh me ken ndër ta ma i epërmi dhe ma i ndryшти za. Lyp me na deh me njat land t'kullume, njate qi din me mruë veç njaj shpirt egrash e njajo zemër përjetimesh t'fuqishme.

Çun Lajçit me ligjërimin e tij i ka dhan za një vullneti t'potërshtëm kushtrimi. Ai nuk ankohet, por tue e ngrit zanin don

me u than njatyne, krejt njatyne qi po i përloqin idealet dhe aspiratate nalta, se na jena njiktu e tue dasht mos me ik, kem sos me luftu, me u ndesh. Me poezi dhe jo vetëm, po don me u than njatyne qi po bajn çmos, qi tue i përbalt gjakun e luftës e amanetin e t'parve, si tue dasht me ba jo ma pak punën e hasmit, se jeni tue gabue

rand fort. Po u thot se ne nuk jem lop qi munden me na ysht me na çua kah duen, as berre me na vu n'rresht, po jem njat me ta, n'mos ma shum'. Poezia e tij asht një za i fuqishëm i denoncimit dhe ndëshkimit, i t'thanmes sw gjanave troç, i t'ngritmes t'zanit n'kup t'qiellit, si tue dasht me mat caqet qi mundet me durue ky krahnor, kjo tokë, ky plis, kjo rrëke gjaku. Për Çun Lajçi, Gëte është i madh, por thënia e e tij

Jo, jo qe besa e Zotit e amaneti i atit. Ai po ban ç'ka mundet me ba, dhe ç'ka din me ba ma mirë, po lëshon kushtrimin, po pisket, po gjuen me sa fuqi ka mbi muret e ndryshkuna t'heshtjes e pajtimit me t'flligten. Ka zgjedh poezinë, njat zjarm qi e nguc prej thellë, me i'u dhan dorzan t'drejtës me lyp me ken ç'ka e bekon. Ai me poezin e tij fort t'andshme i këndon edhe zemrave t'plasuna, edhe gjokseve

këndimin një zemër. Gjithçka qi e trazon njat krahnor n'shtërzim, kur fryma s'e ngin, mëkohen prej njasaj magme për me i'u dhan fluturimit. Lirikja me tragjiken, ditirambi me elegjiaken, ndërthuren kë-sodore si tue dasht me provu se ç'ka gatuen një zemër qi s'e mylmen drita e njatij shpërthimi poterisës. Prejtekta marrin fluturim sa e sa zogj krahtyem e mëkojnë ndër ne njaq amë e amësht, idhnim e gaznim sa ç'mundet me gostit e tashmja, e atypëratyshmja, qi gjithnji ka arsye me e vu n'sprov forcën tonë, se ç'asht n'gjendje me rezistue e sa hov i nep yshtjes me i'u dhan një zani qi nuk len me ndrydh vullnete ndërne.

Kush hala nuk asht gjegj me e kundru kësisoj me u kungue prej këtij zani zjermin e përtrimjes, gjithqysh asht n'kohë me e lan vedin n'kët prehje shejtnore shpirti si n'nji shëlbim.



se, „.gjithçka qi trazon çdo ditë mendimet dhe ndjenjat e poetit, dëshiron dhe duhet të shprehet” mundet me ken një postulat për misionin e Çun Lajçi si vargzues t'tan njasaj qi e përpush e trazon shpirtin dhe brendin e tij.

E bash boll asht tue pas çdo ditë lume njasi qi e ngucin ate.


Askush ma denjsisht s'po mundet me e përfaqsu zanin gjimues të paknaqsisë sa t'dhimbjes se sa Çun Lajçi, poezia e tij, kumtimet e tij zaashpra e britëse, i poroztë e i purpurt, i paqt e i bubushëm.

Poeti por ma shumë se ai, Çun Lajçi, nuk duket se ka sos me ba kompromis me kërrken, n'kët luftë prore, edhe pse nëpër njata gjamë, qi gjuen me tan fuqi qi shpirti i th'rrret, ka prej tyne qi duen me ble, duen me ba ç'mos qi ky za mos me u ndigju ma. Por ai, Çun Lajçi nuk ka ba mend me hesht, me palue vesht e me myll syt', me kqyr veç punën e vet, e mos me u marr me ç'ka po presin me ba me Dardanin e me fatin e ardhmëris s'saj.

t'hovuna prej epshit, edhe syve t'lotuem, edhe nanave e vashave, vorreve e pragjeve, bjeshkëve dhe kreshtave, plisit dhe borës, barit e dushkut. U këndon me njat shpirt qi gazmon e vuen, me njat uzdaqi qi s'e len n'rrug, por tue i mëku zjarm baruti e prush zemre e hov nga kanga n'kang, nga kushtrimorja n'kushtrimore, nga elegjia n'ditiram, nga lirika n'tragjike.

Bubulina mbetet zemërthymja e poetit, e njatij vullneti qi don e s'dron me i'u dhan elegjikes si tue mos dasht me e tret e mshef çka nyjet e fijëzave përjetuese lidhin n'te. Çdo krijus dhe artist ka patun n'jetën e vet nga një muzë, Bubulina e Çun Lajçit asht një prej atyne qi siç zanafillin shkullmin e një dishrimi, mëkojnë ma t'amshten kashat trishtimi. Asht njaja loçk zemre, njaj qiell i thyem ma e trishta qi rrëzon një diell shpirti përnën degët e shkyme të pemës që asht mpleksun në truallin e vet si dihamë e dhimbje.

Çun Lajçi këtij dedikimi i lëshohet me njaq forcë e përjetim, sa çmundet me ushqy





Ne i përkasim asaj kulture, atyre traditave, atij kapaciteti përtëritëse dhe përfaqësues evropian, sa çdokush tjetër në këtë kontinent, edhe pse diplomacitë ogurzeza, orekset babëzitëse shoviniste, padrejtësitë historike, burokracitë e pështira, u përpoqën të hedhin baltë dhe të denigrojnë këtë vlerë, këtë dinjitet. Ne ishim, jemi dhe do të jemi këtu dhe gjithkund ku flitet shqip!



GOJDHENAT PER KELMENDIN

Disa thone se i pari i Kelmendasve ka ardhur prej Lajcit te Hotit, nga Hoti, kurse ne Hot prej Fundanes, nga fshati Lopar, Kucjanet nuk i kane lene rehat ne Lopar, e po ashtu as Hoti ne Hot, e per kete shkak ai ka kaluar ne Kelmend. Derisa ka qene ne Lopar. Ai eshte martuar me nje vajze nga Triepshi dhe ajo e ka percjedhe ne kto ikje. Ai e ka pasur emrin Amat, ndersa gruaja Bumce. Sipas disave, ai e ka pasur emrin Kelmend, sipas te cilit Kelmendasit e kan marre emrin.

Nje gojedhene tjeter, thote se i pari i Kel-

Kelmendi në kapërcejt e shekujve



LUGINA E KËLMENDIT (FOTO: VASEL GILAJ)

mendaseve ka qene nga Piperi, dhe se ka qene rroghtar tek nje kucjan. Aty ka gabuar me nje femer te nje familjeje te mire dhe ka ikur perpjetes se Cemit.

Sipas te gjitha gojedhenave te Kelmendasve. Amati dhe gruaja e tij Bumcja, kure kane ardhur ne Kelmend, jane vendosur ne Bishtan, ne nje vend te pershtatshem

mbi Grabom dhe nen Broje, ne anen e djathte te cemit. Amati aty ka pasur edhe kishen. Ky vende me pare e ka pasur emrin Bisht, por pastaj qekur jane vendosur Kelmendasit aty, e ka marr emrin Bishtan. Gjithkush e nderon kete vende si vendi me i madh dhe me i shejte ne te gjithë fisin, dhe askush nuk guxon ta uzurpoje. Tokat e tjera ne Kelmend te gjitha jane te ndara ne barqe te madha dhe ne vllazeri, ndersa ky vend eshte i pandare dhe i perbashket per te gjithë Kelmendasit. Nje gojedhene tjeter thote se Amati ka pasur shtate djem, tre kane vdekur heret, kurse kater kane mbetur gjalle dhe ata jane: Seli, Vuli, Nili dhe Bogi. Nje tjeter gojedhene thote se Amati ka pasur pese djem: Selin, Vulin, Nilin, Bogin, dhe Leken. Gojedhena te tjera thone se Kelmendi ka pasur djal Amatin, Amati Gjonin, Gjoni pese djemt qe i permendem me larte.

Kure eshte vendosur Kelmendi aty, i ka gjetur disa banor te vjeter dhe nuk ka dashur t'i tregojte askujt se prej nga eshte, si e ka emrin dhe se kushe eshte babai dhe nena e tij. Pyetjes se ciles ai i eshte pergjigjur se "Babe e kam kete toke, nene e kam kete toke". Te moshuarit e Kelmendasve tregojne se ne kohet e vjetra, para se te vendoset Amati aty, kjo ane ka qene e banuar dhe se banoret i ka mbytur semundja e murtajes, jo me kote edhe tani perdoret shprehja kure dikush don te mallkoje dike. Te raftte Mortaja. Dhe se ata qe kane mbetur gjadhe jane

shperngulur nga ky vende, per te mbi-jetuar. Disa prej tyre gjenden ne Sheun e Bardhe, te Tirana dhe te Durresi. Gjurmët e vendbanimeve te tjera gjenden edhe sote ne Selce, te kisha, ne Shkalle, prane burimit te Cemit te Selces, te cilin vende e ka zene shembja e bregut. Ne Radatine jane varret e vjetra, te mbuluara me ferra dhe me bar. Sipas te vjetres, Kelmendi e ka gjetur ketu vetem nje njeri, i cili kishte mbetur mbas Mortajes. Kelmendi e ka pervetesuar ate djale si djale te vetin dhe e ka martuar. Me vone pasardhesit e tij jane vendosur te Tirana. Disa te tjere thone se te paret e Kelmendaseve te sotem kane gjetur ketu do fare banoresh te vjeter prej Italie, te cilet i kane detyruar te zhvendosen dhe pastaj ua kane marre tokat. Ndoshta ta kane qene mbetesit e banoreve te vjeter Romak, te cilet jane shuar. Ne Vukel gjendet vendi Nilaj, ku sipas gojdhene, ka qene vendbanim i vjeter dhe ku gjate germimeve eshte hasur ne objekte shume te vjetra. Ne vendin e quajtur Kodra e Alise, gjate germimeve, eshte hasur ne shume eshtera njerezish. Seli, Vuli, Nili, Bogi dhe Leka, djemte e Amatit, kane jetuar shume gjate ne Bishtan dhe jane shumuar shume. Kure kane sunduar Turqit ne keto vise pra rreth 500 – 550 vjet me pare jane zhvendosur Selca ne Selce, Vukli, Boga, dhe Leka ne Vukel, ndersa Nili ne Nikc. Vendbanimet e tyre gjenden edhe sote tek kishat e sotme ne fshaterat e permendur. Ne Boge, ne ate kohe, kane jetuar Shkrelasit e vjeter, te cilet pasardhesit e Kelmendaseve i kane detyruar qe te zhvendosen dhe te

A RRITE KELMENDI PARA HOTIT?!

Sipas autorit te librit "Kelmendi ne Mjegullnacen e Historise". Kelmendasit Nikolle Shyti, kelmendi e ka patur vendin e pare, ose sic njihet ndryshe kryet e vendit, para Hotit, ne mes tjerash ai argumenton se Prof. Lulash Nika Palushaj ne Librin " Malesia dhe Fiset e Saj". Thote se rreth viteve te para te shekullit te XVIII, nje hotian i quajtur Luc Gjoni me dymbelljet hotian te tjere u shquan per trimeri ne luffen qe bene turqit kunder grekeve ne zonen e Morese. Per kete Veziri i Shkodres kerkon ta shperbleje Luc Gjonin. Ky i fundit i kerkoj vezirit qe Hoti te mos conte ushtar e te mos paguante taksa. Veziri pranon, por me nje kushte, qe Luca duhej t'i falte atij djalin e vet te quajtur Nike dhe te kthehej me gjithë familjen ne besimin mysliman. Ky kusht pranohet. Nika merr emer te ri, Mehmet Luce Gjoni. Qe at'her kjo shtepi behet e famshme dhe i jepet titulli i nderit "Prijes i te gjithë bajraqeve te Malesise se Madhe". Deri ne ate kohe titullin e bajrakut te pare e kishte mbajtur Kelmendi.

Vasel Gilaj

vendoset, ne vendbanimet e tyre te reja poshte Lugines se Sheut te Thate. Me vone i emeruar me emrin Perroi i Thate. Qe do te thote se ka uje kure ka rreshje shiu. Ky perrua eshte 42 km i gjate buron ne Qafen e Terthores mbi Boge ne Kufi me Dukagjinin konkretishte me Thethin dhe derdhet ne Liqenin e Shkodres, ne Fshatin Kamice. Keshtu pase Shkrelaseve kane ardhur ne Boge pasardhesit e Bogeve ose Bogaseve te Kelmendit. Kelmendasit jane shtuar shume shpejt. Sot sipas tyre, vendas dhe te shperngulur ka 1000 shtepi, me mbi 4000 pushke. Sikurse Malazet qe dikur jane numeruar me pushke, po ashtu edhe Malesoret numerohen me pushke. Kelmendasit ndahen ne kater barqe te medha. Selca prej Selit, Vukli prej Vuklit, Nikci prej Nilit dhe Boga prej Bogit. Te

cilet nga shtesa numerike konsiderohen edhe si fise te Kelmendit.

Selca ka 12 mehalle ose vllazeri. Nikmartinaj, Bujaj, Mernacaj, Dedkolaj, Vushmacaj, Nikgjonaj, Radatinaj, Rexhaj, Vuktilaj, Vrataj, Gjonaj (Gjonoviq) dhe Lelcaj. Nente vllazerit e para jane pasardhesit e drejtperdrejte te Selces dhe quhen me nje emer te perbashket. Rabjen, Radatinaj, dhe Rexhaj martohen mese veti dhe me vllazeri te tjera, por jo edhe me shtate vllazeri te tjera. Kjo sjedh ne supozimin se pasardhesit e Selces jane prej tri degeve. Lelcajt mbajne prejardhjen prej nje femre, pasardhese e Seles. Nje nuse prej pasardheseve te Seles kishte qene e martuar para 250 vjeteve ne shekullar, ku e ka pasur nje djalin, kure ka mbetur vejushe, eshte kthyer ne gjini, duke marre me vete edhe djalin, nga i cili eshte vllazeria Lelcaj. Vrataj dhe Gjonaj jane pasardhesit e Lekes, te djalit te peste te Amatit. Leka

afert i vellait Vul, nga Vukli, eshte vendosur dhe zhvendosur, sikur thone Kelmendasit, ne Piper, prej nga sipas nje Gojdhene, ka qene baba i tij Amata. Djali i Lekes, meqe babai i kishte ikur, zhvendoset prej Vuklit ne Selce dhe prej tij e mbajne prejardhjen vllazerit ne Selce. Vrata dhe Gjonajt, Vrata dhe Gjonajt u takojne Selcaseve dhe flamura te Selces, pore sa here qe keqesohen me Selcas, kerkojne ndihmen e Vuklit dhe keta ua japin. Vukli ndahet ne kater mehalle. Vuksandedaj, Cekaj, Anas, dhe Gjecaj. Nikci ka tri mehalle. Vukdedaj, Gildedaj, dhe Delaj. Vllazerit e Vuklit nuk martohen mese veti, po ashtu as Nikci. Edhe njeri

KELMENDI 6000 VJECAR

Kelmendi, Mali, Fisi, Bajraku apo Zona me veriore e Shqiperise "Londineze" 1913, pa dyshim eshte nje nder trevat me te rendesishme nder shekuj dhe sot, te Malesise se Madhe dhe krejt Shqiperise Etnike. Kelmendi eshte " Muzeu " i gjadhe ku mund te lexohet pa mydyshje gjithë rruga e Autoktonise mijeravjecare, jo vetem te banoreve autokton Kelmendas , por edhe te krejt races sone, nga Iliret e mocem te Shqiptaret e sotem. Ne kete Muze te gjalle gjinden gjurme te "fresketa" ku mund te bashkohen Qiellorja dhe toksorja, Hyjnorja dhe Njerezoria. Primitivja dhe Modernia, Humbja dhe Fitorja, Miti dhe Legjenda, Enderra dhe Realitati.

Sipas shume gojdheneve si dhe fakteve e deshmive, thuhet dhe mesohet se gjurmët e jetes ne Kelmend jane se paku. 6000 vjecare, ku filluan te banojne njerezit e pare primitiv apo gjysem primitiv.

Ndue Bacaj

KELMENDI I RRETHUAR NGA SHQIPTARET

Kelmendi sot kufizohet ne Veri – Perendim me Teritore te shtetit te Malit te Zi, qe te Gjitha dikur troje dhe popullsi Shqiptare. Si Kuci, Vasojeviqi, Triepshi, Gruda, dhe Gucia. Ne lindje kufizohet me Gash e Krasniqe, ndersa ne jug me Hotin, Kastratin, dhe Shalen e Dukagjinit te Shqiperise. Perimetri i kufijeve eshte 102 km gjithsejt, nga ku 99.5 km jane kufi toksore, dhe vetem 2.5 km jane kufi lumor.

Kufiri me Malin e Zi ka nje gjatesi prej 68 km ose 67 % e krejt kufive te pergjithshem te Kelmendit.

Kufiri shtetror i Kelmendit ka kaluar shume peripeci, me Malin e Zi, qe nga viti 1913 e deri ne vitin 1926 kohe kure u muaren nga shteti shqiptar Tokat e Libovices e Vermoshit, deri at'her te pushtuara nga Mali i Zi. Kelmendi ka nje shtrirje Maksimale Lindje – Perendim prej 25 km, ndersa Veri – Jug prej 24 km. Siperfaqja e Kelmendit brenda kufive shtetore eshte 353 km².

Ndue Bacaj

edhe tjetri martohen me vellazeri te tjera te Kelmendit. Selca ka nje bajraktar dhe kater vojvode, Vukli ka nje bajraktar dhe te vojvode, Nikci nje bajraktar dhe tre vojvode dhe Boga nje bajraktar dhe dy vojvode. Per Leken thone se eshte shperngulur ne Piper, por ne Kelmend nuk dihet asgje per te. Ne Cekline eshte nje gojedhene qe thote se malesoret te cilet jane 600 shtepi, kane prejadhjen prej njefare Leke, i cili ka qene prej Kelmendit dhe eshte vendosur me heret ne Piper, pastaj aty eshte martuar me nje vejushe dhe eshte zhvendosur ne Cekline, gojedhenat e Ceklines jane te ngjashme me kete te Kelmendaseve dhe me siguri malesoret e Ceklines kane prejadhjen prej Lekes, djalit te Amatit. Ne Kelmend nuk dihet pse Leka e ka lene djalin dhe ka shkuar ne Piper. Mendohet te kete ndikuar ndonje arsye e madhe, ndoshta edhe kercenimi me jete. Ne Piper Leka eshte martuar me nje vejushe c' tregon se nuk ka qene djali i pamartuar por vejan. Sipas kesaj gojdhene, kinse Leka eshte zhvendosur ne Piper, del se Kelmendi ka qene prej Piperit, sepse Leka ne kete menyre ka kerkuar strehim ne farefisin e afert. Leka e ka festuar Shen Nikollen me 6 Dhjetor. Dhe e feston edhe sote i tere farefisi i tij. Te njejten feste e kane pasut te gjithë Kelmendasit. Vendosja e Kelmendaseve ne Kelmende eshte e hershme, ndoshta me e hershme se ajo e te pareve te Hotit, dhe te Grudes e tjer. Duke studiuar brezat e disa vellazerive, arrihet ne perfundimin se Kelmendasit jane vendosur para 500 vjeteve. Kelmendasit jane shtuar shume shpejt dhe

hapesira e vendit te tyre nuk u ka mjaftuar. Daljet e Cemit jane shume te vogla per vendbanime te medha. Kelmendasit kane mbetur te lidhur per kete vende vetem per shkak te hapsires se abajeshkeve te Medha, pasi kullosat ua kane kompensuar te gjitha mangesit e tjera. Sa here qe Kelmendaseve u ka ardhur puna ngushte, e kjo ka ndollur sa here qe zeja e tyre blegtorale eshte rritur, kane kerkuar zgjerim dhe dalje teposhtes se Cemit, neper Fushe te Zetes, ku ka pasut kullosa te mira per dimerim, por kure atje kane hasur ne rezistence me

te forte te Hotit, te Grudes, te Triepshit dhe te Kucit, athere jane leshuar grykave te Sheut te Bardhe, neper Vermosh, ne Guci dhe ne rrethine. Kelmendasit jane vendosur ne Guci dhe perreth lumit Lim, deri ne Peshter dhe Sjenice, Bosnje dhe Shumadi, keshtu qe ata kishin pervetesuar shume vende te mira, duke u bere zote te lugines se Limit. Por mr vone, meqenese Kelmendasit sipas autorit ishin sjedhe keq te cileve ua kishin marre tokat, qe dihet se kane qene Ilire. Kelmendasit hasen ne kundertshti te madhe ne keto vendbanime nga banoret qe gjeten atje, Po ashtu Kelmendasit kane hasur ne rezistence te forte edhe nga Myslimanet e Plaves, te komandanti i Pejës Mahmut beu dhe te Vasojeviqte. Keshtu mbas 50 vjeteve qe kishin banuar ne luginen e Limit, ishin detyruar te terhiqen prapa ne bjeshket e tyre. Prej athere ne kete lugine kane mbetur disa vendbanime te Kelmendaseve. Vuthajt, Martinajt, Nokshiqi, Rugova e tjer. Kjo dyndje e Kelmendaseve ne Plave, ne Guci dhe ne Luginen e Limit e ka zvogluar goxha shume popullaten ne Kelmend sepse nje pjes e madhe e tyre ka mbetur ne ato vende te zaptuara.

Deshire e madhe e Kelmendaseve te asaj kohe ka qene zgjerimi i hapsirave te tokave te tyre, edhe pse ne dem te fiseve



MULLINI I VUKLIT

CEMI I SELCES DHE CEMI I VUKLIT

Kelmendi pershkohet nga dy Lumej te cilet jane. Cemi i Selces dhe ai i Vuklit, bashkimi i te cileve formon Lumin e njohur te Cemit te Kelmendit. Me gjatesi prej 62 km, ku Kelmendin e pershkojne 30.8 km. Sasia e ujit eshte 26 m³ per sekond, nje here ne 100 vjet thuhet se shkon deri ne 300 m³ per sekond Cemi i Vuklit ka nje gjatesi 17. km, ndersa Cemi i Selces 22.5 km. Lumi i Vermoshit ka nje gjatesi prej 20.7 km. Kelmendi ka edhe Liqene malore ku me te rendesishmit jane Liqenet e Jezerces. Por ka edhe te tjere te vegjel, si Liqeni i Pecakeqit, i Smutiroges, i Mojanit dhe Seferces, e tjer. Dikur neper kelmend ka qene nje rruge kembesore, si dhe kafshesh qe e ka lidhe me Podgoricen, Medunin dhe Prizerenin. Kelmendi ka keto largesi me disa qytete si me Koplikun qender e Malesise se Madhe 41 km, me Shkodren 58 km, dhe me Podgoricen 52 km. Distanca dhogaritet nga qendera e Kelmendit qe eshte Tamara.

te tjera. Duke pasur jo pak suksese diku me presion, diku me grabitje e deri edhe me luftime. Supozohet se ne ate kohe ne Bjeshket e Nemuna sqarim i perkthyesit ka pasur shume bjeshke te cilat nuk i ka shfrytezuar askush shumte prej tyre kane qene large Gucise, madje as siguria nuk ka qene e garantuar. Per bjeshke jane pyetur Veziret e Shkodres, si dhe komandantet e Plaves dhe Gucise, prandaj edhe ata kane mundur ti shfrytezojne lirshem keto bjeshke. Ne ate kohe Veziret e Shkodres kane shitur shume bjeshke ose ia kane falur dikujt disa prej tyre, te cilat pastaj keta i kane ruajtur per vete ose i kane shitur perseri. Flitet se Vuksandedajt e kane blere bjeshken e Stocices prej Ali pashe Gucise. Dhe se seicila shtepi ka dhene nga 20 oke kripe demshperblim. Sipas fjaleve te Kelmendaseve, bjeshka e Brades dikur ka qene e Kelmendit, por ua ka uzurpuar Veziri i Shkodres prej athere quhet Brada e Vezirit. Veziret e Shkodres e kane pasur zakon qe nga njerez, vellazeri dhe fise te konfiskojne prona, zona te tera fusha te gjera dhe kodra me bar prane detit dhe ne nen Shkoder. Kjo eshte u eshte hakmarre, sepse ne funde kane mbetur te vetmuar dhe kane pesuar disfate ne ballafaqimet luftarake me forcat otomane turke te sulltanit. Seicili farefis i Kelmendaseve eshte zgjeruar ne anen e vet dhe seicili e ka shtyre kufirin, duke filluar me se pari me bjeshke. Selcasit kane perfituar me se shumti dhe jane ndare te kenaqur. Ata gjate ndeshjeve me Kucjanet ishe Shqiptare por te Malazezizuar ne fe dhe atdhe

c'ka autori nuk e thote. Kane pasur shume mosmarrveshje, nga te cilat kane perfituar se ua kane marre bjeshket si Jezhidolin dhe Gropen e Mojanit. Nuk besohet se keto bjeshke kane qene ndonjeher te Kucit, por Kucasit munde ti kene Kullotur bagetin ne to. Ne Morace tregojne se dikur Moracanet i kane pasur bjeshket e veta ne Kome, ne te cilat i kane kullotur delet. Kelmendasit per shkak te ketyre bjeshkeve kane luftuar kunder Moracoreve. Nje gojedhen tjetër thote se dikur Kelmendasit i kane pasur bjeshket deri ne Orahova dhe Kuci. Por me vone i ka detyruar Kelmendasit te terhiquen deri te kufiri i sotem i Kelmendit. Ne Kelmend thone se Kucjanet ne kohet e vjetra jane vrare mes veti dhe se ne ate luftime jane dopsuar e paksuar aq shume sa Kelmendi ua ka marre te gjitha bjeshket.

Vetem kur Kucjanet jane pajtuar mes veti, Kelmendasit jane terhequr.

Kelmendasit kane mbajtur ndonjeher miqesi me Kucasit. Sa here qe turqit kane sulmuar Kucin apo Kelmendin, ata jane bashkuar per t'u mbrojtur. Keto dy fise e kane pasur fjalen kryesore midis fiseve malazeze dhe te malesise se madhe, ndersa fiset e tjera kane qenderuar prane tyre. Kujtojme ketu edhe pse aotori Malazias nuk e pranon se ne vitin 1700 per te mos u konvertuar ne besimin Mysliman se 400 familje Kucase qe te gjithë Shqiptare, jane kthyer nga besimi katolik ne ate ortodoks, sqarim i perkthyesit. Kure turqit e kishin sulmuar nje here Kucin, 40 Kelmendas u kishin shkuar ne ndihme Kucjaneve – Shqiptare dhe turqit e kane humbur luften. Keshtu Vermoshi u ka mbetur Kelmendaseve. Ne kohen kure Kucjanet kishin ikur ne Llutove dhe ne Rovc, Veziri i kishte zaptuar disa bjeshke te Kucit si Mojanin dhe Smutirogen dhe ua kishte dhene Kelmendaseve kullosat me pagese. Kelmendasit per kullose, cdo vit i kane paguar Vezirit per 25 dele nga nje qengj, per 50 dele nje rrunxak, kurse per 100 dele nje dele tri vjece, kete e kane bere derisa veziri ka qene ne Shkoder, Ne kete menyre Kelmendasit e kane pasur deren hapur kah Plava, Gucia dhe Lugina e Limit. Kelmendasit e kane shfrytezuar menjeher kete mundesi. Kelmendasit jene blegtoret me te medhenj ne Bjeshke te Nemuna. Mbas terheqjes se Kelmendaseve nga lugina e Limit dhe riatdhesimit ne vendlinjen e tyre te ngushte shume Kelmendas kane

KELMENDI ME VETEM 3000 BANOR

Ne fillim te viteve 1990. Kelmendi se bashku me Bogen, qe eshte ne njesin Administrative te Shkrelit per shkak te largesise qe ka me Kelmendin, ka patur 7000 banor, te cilet kane banuar ne 9 fshatera qe jane. Selca, Broja, Tamara, Vukli, Kozhnja, Nikci, Lepusha, Vermoshi dhe Boga. Ndersa tani per shkak te emigracionit numeron rreth 3000 banor e ndoshta edhe me pak. Qe do te thote se mungojne 60 % e banoreve shumica te larguar jashte vendit, pore nuk mungojne edhe ata qe jane vendosur ne zonat fushore brenda vendit. Ne vitin 1635 gjindet e shkruar se Kelmendi kishte 300 shtepi dhe 3200 banore.

Ne vitin 1909 ose rreth 100 vite me pare rezulton se Kelmendi ka patur 750 shtepi dhe 4700 banor. Kjo per shkak edhe te lufterave te shumta te zhvilluara her pas here, si dhe largimit te banoreve nga vendlindja.

“Zani i Malsise”

zbratur me bagtite e tyre fillimisht ne Dukagjin, e me pase deri edhe ne Gjakove, ne Bregdetin Adriatik, ne Ulqin e deri ne Durrës. Keto levizje te Kelmendaseve, kane filluar para rrethe 200 – 250 vjeteve dhe vazhdojne edhe tani. Kelmendasit ne bregdet kane gjetur toka te bollshme dhe livadhe. Kelmendasit qe zbrisnin dimrit ne bregdet veres ngjiteshin me bageti ne bjeshket e tyre. Ne rrethin e Gjakoves ka vendbanime qe jane krijuar prej Kelmendaseve te ardhur. Vendbanime te Kelmendaseve ne bregdet jane ne Ishem, Breg te Matit, Fushe Kuqe, Gurz, Velipoje ne disa zona te nen Shkodres, Shtoj e tjere. Kelmendas te shperngulur me rreth 300 shtepi ka edhe ne Hungari per keto shperngulje gojedhena thote. Turqit sipas disave Arabet, kure e kishin okupuar Bosnjen, Zulumi kishte filluar edhe ne Peje, Plave dhe rretnine por presioni me i madhe ishte bere ne Kelmend, keshtu qe shume Kelmendas kishin filluar te shperngulen. Ardhja e Kelmendaseve te pare ne rrafshin Hungarez ka ndollur pikerishte athere. Pjesa tjetere e Kelmendaseve qe kishte mbetur ishte fshehur rrethe Cemit, neper shpella, ku kishim mbijetuar duke ngrene arra te lisit. Dhe ne vend te kripes, kane perdorur levozhgen e brendeshme te frasherit. Kure jane terhequr Turqit (gjegjesisht arabet) prej ketyre viseve shume kelmendas jane kthyer ne shtepit e tyre.

Edhe ne Kelmend ishte gojedhena per eren shtatvjecare te veriut, e cila ka shkaktuar aq dem dhe uri, sa njerezit jane detyruar serish te shperngulen. Me ate rast nje pjese e Kelmendaseve ishte vendosur ne Budva. Ku pasardhesit e tyre jetojne edhe sot, kjo

KELMENDI I 13 VOJVODEVE DHE 4 BAJRAKTAREVE

Kelmendi se fisi me i madhe ka patur 13 vojvode. Dhe konkretishte ne Selce-4, ne Vukel-4, ne Nikc-3 dhe ne Boge- 4. Ne Selce shtepi Vojvodesh jane Nikmartinajt dhe Bujajt. Dikur edhe vellazeria Macaj e ka patur Vojvoden. Ne Vukel shumica e shtepive te Vojvodeve jane prej Vuksandedajve, kurse ne Nikc prej Gildedajve. Njeri prej Vojvodeve te Nikcit ishte edhe prej shtepis se Myslimanizuar Vukdedaj.

Ne Boge, bajraktar ka qene Nike Prela para tij ka qene Prel Toma, Ton Vuksani e tjer. Te cilit para e vendit ia ka marre bajrakun dhe ia ka dhene nje kusheririt te tij, sepse Nike Prela nuk ka qene trim i madh dhe njerezit jane frigesuar se mos po korit veten dhe fisin, prandaj e kane nderruar. Ky eshte rasti i pare e ndoshta edhe i vetem ne Malesin e Madhe qe dikujt ia kane marre bajrakun. Regulli ka qen, qe askujt deri sa te jet gjadhe te mos i merret bajraku. Sa u takon Bajraktareve seicili fise, pra te kater fiset e kelmendit kane patur nga nje bajraktar, ose kater gjithsejt.

“Zani i Malsise”



VUKËL, KELMEND NJË KRYQ ME IMAZHIN ETË-VDEKURIT, 18 MAJ 1908

ka ndollur para 270 vitesh. Disa prej ketyre Kelmendaseve, te anes se Budves, kane ardhur para 20 vjeteve ne Kelmend dhe i kane ftuar keta te vendit per te shkuar atje. Njefare Pak Nika, me tre djem, prej Selces ishte zhvendosur moti per shkak te nje vrasese dhe ishte vendosur ne Rehove. Dy djemt e tij, kur jane rritur, jane martuar me dy vajza nga Kuci dhe kane mbetur ne Rehove, ndersa I treti ishte martuar me nje katolike dhe ka mbetur ne Kogjim ne Kuc. Dy vellezerit e pare konvertohen ne fene ortodokse dhe prej tyre tani jane Pajoviqte dhe Nikiqte, ndersa i treti nuk e nderron fene e vet katolike dhe se prej tij tani jane Nuculoviqte. Dikur jane pajtuar me Selcas por nuk kane dashur te kthehen me ne vendelindje, dikur ishin ngaterruar Kucasit me Kelmendas ne korita te Hotit dhe Kucjanet kishin zene rober dy Kelmendas. Kucjaneve u kishte ardhur keq pse Nikiqte dhe Pejoviqte kishin mbajtur gjithmone lidhje farefisnore dhe miqesore me Kelmendasit. Me te cilet Kuci ka qene i armiqsuar. Kucjanet per ta kthyer miqesine ne armiqesi, e detyrojne nje burre te njohur te Nikiqeve qe tua pres kokat dy kelmendaseve te zene rober. Nikiqi e kishte bere ate masaker kunder deshires

NIKCI BAJRAKU I PARE I KELMENDIT

Bajraku i pare i Kelmendaseve ka qene Nikci. Thone se bajrakun e pare Kelmendaseve u ka dhene sulltani. Kur Kelmendasit jane shtuar dhe ndare ne kater dege Veziri i Shkodres, Mustaf Pashe Bushatliu u ka dhene seicilit nga nje bajraktar. Duke dashur qe ta kete mbeshtetjen e ketij fisi te madhe. Mesohet se Nikcjaneve ose Nikcit, bajraku ose vendi i pare u eshte dhene edhe per shkak te Myslimanizimit te disave prej tyre aso kohe. Nikcjanet kane qene pakic dhe nuk kane guxuar ase qe te ndahen prej fisit te tyre, sepse ne ate rast do te humbnin dhe nuk do te llogarisnin me se Kelmendasit e tjere, do tu ndihmonin ose do tu shkonin mrapa. Kjo i ka detyruar qe bajrakun t'ua leshojne Selcasve si Vellazeria me e madhe e fisit. Gjate ketit dorezimi te bajrakut nuk ka ndollur kurrfare mosmarrveshjeje.

“Malsori”

se vet, qe te mos bier fare ne dyshim ne te, dhe kure e ka pyrtur ndonje njeri “ K eke prere” ai eshe pergjigjur “Vellane dhe djalin”. Ai e ka ditur se kete do tua paguaj Kelmendaseve. Ashtu edhe kishte ndolur. Njehere, kur njerezit e tij kishin qene duke qethur delet ne te njejtin vend ku ai kishte prere dy Kelmendas, u kishin rene befasisht Kelmendasit dhe ia kishin prere Nikiqit vellane edhe djalin. Jovan Erdele- noviq, ka shenuar se Nikiqte dhe Pejoviqte prej Kastrati jane vemdosur se pari ne Selce dhe me vone prej aty kane shkuar ne Kuc. Kucjanet dhe Kelmendasit dikur jane ftuar ne gazmende te “kuleceve dhe te vajzave”, pra ne dasma por kane shkuar edhe neper festa. Kjo miqesi ndoshta ishte per shkak te Nikiqeve dhe Pejoviqeve. Kjo nuk i ka konvencuar pushtetit turk ne Shko- der, prandaj i fut ne ngaterrese per shkak te mezhdave te bjeshkeve rreth te cilave jane zene deri tash vone. Turqit pastaj, menduan se nuk do te pajtohen lehte keto dy fise te medha e te forta e as qe do te kete me aksione te tyre te perbashketa kunder turqeve. Kalugjeroviqte e Zetes kane prejardhjen prej Kelmendit dhe dhe ndahen ne Balijash, Rakoviq, Mijatoviq dhe Beloviq. Te gjithë Kallugjorevique kane 45 shtepi dhe festojne Shen – Petkun. Peraciqte ne Godinje, Merkoviqte dhe Peshtoviqte jane Kelmendas dhe festojne Shen Nikollen (6.XII)si dhe Kelmenda- sit e vjeter. Debanoviqte, Peroviqte dhe



Pepoviqte nga Selca ne Cernice, jane nga Kelmendet. Kelmendasit e vendosur ne Krahinen e Plaves e Gucise, ne Peshter, ne rrethine e Gjakoves, ne Kraje dhe ne Ana- mal kane kaluar ne fene islame. Ne kete i ka detyruar pushteti turk, nen sundimin e te cilit kane qene. Por me nderrimin e fese

nuk kan nderruar dashurin per vendin e tyre. Ata kane ruajtur shume doke dhe za- kone fetare te cilat i kane trasheguar prej paraardheseve te tyre katolik. Kelmendasit e shperngulur ne bregdet kane ruajtur fene katolike dhe gjithmone kane mbajtur lidhje me vendelinjen e tyre. Kelmendasit e tjere ne vendelindje jane katolike, me perjashtin te 9 familjeve ne Nikc qe jane myslimane. Delajt 6 dhe Gildelaj 3 shtepi. I pari qe es- hte konvertuar ne myslimane eshte Dela, nga familja Hamza, nga Shkodra, ne kohen e vezirit te shkodres. Veziri kishte bindur Delen per te kaluar ne fene myslimane, duke e bere edhe bajraktar, menyre kjo e zgjedhur me qellim per te pasur ndikim me te madh te Nikcasit dhe te Kelmendasit e tjere. Por nuk ia kishte arritur qellimit. Kel- mendasit, jo vetem qe shtrihen ne hapsiren me te madhe te Bjeshkeve te Nemuna por ata edhe jane shperngulur me shume se cdo fise tjeter i malesoreve. Ata ne vendin e vete numerojne mezi 350 shtepi, ndersa te emigruar dhe te shperndare ka gjithkunde, prej Detit Adriatik e deri te lumenjte Save dhe Danub, si edhe prej Llovqenit e deri te Gjakova, Prizereni, Durresi, dhe Tirana mbi 4000 shtepi.

KELMENDI I DY PAPEVE

Kelmendi eshte afruar, prane besimit Kristian qe me predikimet e para ne Iliri te Shen Palit, k viti 58 pas lindjes se Krishtit. Dhe kjo vertetohet nga Emri i Papes se trete, zevendesit i trete i Shen Pjetrit me emertimin Papa Klementi I – re, i cili ishte Pape ne vitet 90 deri ne 101 pas lindjes se Krishtit. Madje ky Zevendes i Shen Pjetrit u martirizua duke predikuar, Fjalen e Jezu Krishtit nder pagane. Eshte pikerisht ky shenjeter qe nga banoret e Kelmendit u mbajte si mbrojtës i fisit te Kelmendit. Dhe ne vijim traditave kristiane per shenjeteret, Kelmendasit shejtit te tyre Shen Klementit i kushtuan qe i luteshin ne kishat e tyre. Ne funde te shek. I – re dhe fillimit te shekullit te II – te fillon te degjohet per here te pare edhe emri Klementi qe i afrohet trajtes se mevoneshme Kelmendi. Keto mesemiri i verteton egzistenca e Keshqjedhes e quajtur Klementina qe gjendet ne Vuklin e Kelmendit. Papa i dyte dhe qe edhe ai eshte nga Kelmendi eshte Papa Klementi i XI - te, familja e tij eshte larguar na Kelmendi ne vitet 1497, kohe kur Turqit Pushtuan Kelmendin. Ne krye te kishes Katolike ka qendruar, nga viti 1700 deri ne vitin 1721. Emri me te cili u pagezua kur limdi ky Pape ishte Gjon Francesk Albani. Ai do te mbetet pergjithmon ne kujtesen historike te Shqiptareve, per organizimin e Kuvendit te Arberit ne vitin 1703, permes te derguarit te tij. Vicens Zmajevik.

Ndue Bacaj



PAMJE E FSHATIT BOGE

TESHTE BOGA

“Teshte Boga”. Kete shprehje, e cila sipas gojdhenes eshte shume e hershme, e has dhe e degjon jo vetem ne Boge, por pothuajse ne te gjithë Malsine e Madhe. Dhe posacerisht kur banoret e tjer, jo te Boges, takojne nje Bogian ne rruge apo kudo tjeter, duke u perpjekur, qe ai ose ajo, ti flas Bogianit, ose ta pershendes me perpara me argumentin se nese Bogiani te flet i pari. E gjithë dita nuk do te jet e mire ose sic shprehen Malsort, do te prihet mbrapsht, vecanarishte kjo ndoll deri ne oren 12 te mezdites.

Ku jo pak malsor, e shikojne oren kure perpara tyre del nje Bogian. Po si eshte e verteta dhe nga ka ardhur e buruar kjo shprehje, e cila eshte trashiguar dhe perdoret edhe ne ditet tona. Ne kohën e principatave Serbe, kur Serbet her pas here sulmonin trevat e Malsise se Madhe, e se bashku me to edhe Bogen, perpara se te vinte ushtria Serbe, ata pritnin ose sharroni n lisat e gjate te drurit te Ahut, duke i lane vetem sa mos te rrezoheshin, kur vinin Serbet. Bogianet rrezonin lisat e gjate e te medhenj duke i hellur mbi trupat e ushtareve Serbe, duke mos e kuptuar se c' fare po ndollte dhe te habitur nga ngjarja Serbet filluan qe ti thonin njeri – tjetrit, se ne kte vend mos te cofte zoti. Koherat kalonin dhe Serbet duke e treguar kte ngjarje, u formua shprehja “ Teshte Boga ”.

Vasel Gilaj



KELMENDI SHTRIHEJ NGA PEJA NE KOTORR

Prof. Cabej ne njesin enciklopedike per Kelmendin ne vitin 1942, shkruan se "Kelmendi, fis i Shqiperise Veriore perbehet nga kater bajraqe. Selca, Vukli, Boga dhe Nikci (Nikolla) i vogli, tre te paret Katolik dhe ky i fundit i Islamizuar. Sipas tradites se fisit, themeluesi i ketij fisi quhet Klemens ose Klemenco. Ky kishte shtate djem prej te cileve rrjedhin perkatesisht, Selca, Vukli, Nikshi, Vuthaj, Martinoviq, Bukova, e Dukagjinit dhe Liapi i Kosoves. Edhe familja e Dragajve ne Mitrovicë eshte e vetedijeshme qe e ka prejardhjen Klementinase. Po ashtu rrjedhe Kelmendi ka edhe popullsia e Rugoves ne nahijen e Pejes. Duke iu referuar ketij konstatimi te Hahnit, studiuesi Z. Neziri thekson se Rugova eshte zone e thelle malore ne Alpet Shqiptare. Dhe i takon krahines se gjere te Kelmendit, qe shtrihej nga Peja e deri ne Kotorr, ne shekullin e XVII.

Prof.Dok. Begzad Baliu

SHPELLA E FRATIT

Ne vitet e veshtira te pushtimit Otoman shpesh Kishat rrenoheshin apo ndaloheshin, ku Frenit detyroheshin te predikonin fene Katolike neper Shpella apo vende te fshehta. Sa per Ilustrim mund te permendet vendi i emertuar nga banoret vendas, me emrin. Shpella e Fratit dhe qe ndollet ne Kozhnje. Aty thuhet se e predikoi fene e krishtere nje Frate gjate sundimit Turk. Gjithsesi periulla me e veshtire per Kelmendasit, ashtu si per te gjithë Shqiptaret, ishte periulla e pushtimit te gjate Otoman. Binomi Fe e Atdhe ishte altari qe e mbante gjadhe kete treve Katolike. Deri ne funde te pushtimit Turk e tjer, pushtues qe erdhen me pase. Ne vitin 1912 sipas te dhenave ishin Myslimanizuar 3% e banoreve te krejt Kelmendit, ndersa nga Vellazerit Nikci ishte Myslimanizuar me shume me rreth 10% te banoreve. Por qe gjithsesi e ruanin dhe e rujne edhe sot harmonin e vllazerin, pa asnje ndasi ne gezime, hillerime apo kushtrime.

Vasel Gilaj

BJESHKET E KELMENDIT

Bjeshket e Seferces jane ne skajin me verior te Kelmendit e Shqiperise "Londineze". Siperfaqja e ketyre Bjeshkeve eshte rreth 27 km2 dhe me nje lartesi qe i kalon 1600 metra mbi nivelin e Detit si mesatare. Kjo bjeshke perbehet nga Kurrizet Malore, Zihove, marlules, dhe Lugu I Harushes. Bjeshket e Nemuna, si nje nder bjeshket me te njohura ne Shqiperi e me gjere.

Me keto Bjeshk lidhen Legjenda e Trimeri, vecanarisht ato te Kreshnikeve. Lartesia e majava te bjeshkeve te Nemuna eshte me e larta ne Shqiperi. Pasi jane dhjetra maja qe e kalojne lartecin 2000 deri ne 2500 m mbi nivelin e detit. Vlen te theksohet se ne Bjeshket e Namuna ndodhet blloku i Jezerces qe njihet si "Catia" e Alpeve Shqiptare, madje vete Maja qender e Jezerces ka lartecin 2692.1 metra mbi nivelin e Detit. Kelmendi ka edhe bjeshk te tjera, poer edhe lugina te mrekullueshme, ku luginat me ne ze jane Luginae Vermoshit.dhe Lugina e Cemit. E tjer.


Kole Progni

KELMENDI PARA 100 VITEVE

Ne Selce jane fshaterat. Selca me 25 shtepi, Dobrija me 7, Pojata me 8, Pashkalla me 7, Osoja me 6, Mreku me 18, Jasenova me 15, Oshtriqi me 2, Javori me 5, Gropa e Zeze me 4, Vana me 4 dhe vermoshi me 43 shtepi. Qe do te thote se Selca ka 144 shtepi. Dhe ndahet ne Mahallet. Vrate, Gjonaj, Radetine, Pepaj dhe Gobaje.

Vukli. Ka 121 shtepi, kurse Nikci 83. Vuklit i takojne fshaterat Kozhnja me 6 shtepi, Grabomi me 6 dhe Eltoshi me 5 shtepi. Fshati Vukel ndahet ne Vuksandedaj, Cekaj, Anas dhe Gjec. Nikcit i takojne fshaterat. Broja, Pahovica, Kalca, dhe Tamara. Fshati Nikc ndahet ne mahallet Vukdedaj, Gildedaj dhe Delaj. Nikci ka Kishen dhe Xhamin e vet. Aty jane 6 shtepi te fese myslimane. Boga numeron reth 40 shtepi dhe ndahet ne dy, fshatera kryesore e ne shume raste edhe si mahalle qe jane Precaj dhe Kolaj. Precajt jane kryesore, pasi prej tyre eshte Bajraktari, dhe se ne Precaj ndodhet edhe Kisha e Shen Mehillit. Sa i takon numerit te Banoreve Kelmendi para 100 viteve ka patur keta banor. Selca me Vermoshin 970 banor, Vukli 736, Nikci 651, ndersa Boga 350 fryme banoresh. Gjithsejt 2707 banore afersishte aqe, sa Kelmendi ka edhe tani kure jemi ne vitin 2018.

"Malsori"



Karagjorgje, kelmendasi që themeloi dinastinë sunduese serbe

Lufta në mes Austro-Hungarisë dhe Turqisë, e njohur si Lufta e Vjenës - e cila ka zgjatë nga viti 1683 deri në vitin 1699 - ka shkaktuar ndryshim të madh në strukturën etnike të popullsisë së Sanxhakut. Lufta ka shkaktuar shumë viktima dhe shkatërrime, ku si rrjedhojë pason shpërngulja e popullsisë së Sanxhakut në shumë drejtime. Në drejtim të Bullgarisë dhe Azisë së Vogël është shpërngulur popullsia e besimit islam. Popullsia katolike e fisit Kelmend është shpërngulur në drejtim të veriut, në Srem, dhe është vendosur në fshatrat: Hrtkovci, Nikinci, Pllatiqevo dhe Jarak. Një degë e të shpërngulurve në drejtim të Shumadisë është vendosur në fshatin Rudnik. Në këtë fshat është vendosur gjyshi i Karagjorgjes, Jovan (Gjon) Marash Klimenti (Kelmendi)

Ismet Azizi

Ekzistojnë kontradikta në lidhje me origjinën . Burimet serbe thonë se Gjorgje (Gjergji) Petroviq (Pjetri) ka prejardhje malazeze nga fisi Vasojeviq (që po ashtu ka origjinë shqiptare e që kanë luftuar gjithnjë kundër shqiptarëve - v.j.). Atje ka lindur gjyshi i Karagjorgjes (Gjergji i Zi), Jovani (Gjoni) dhe katër vëllezërit e tij. Dy nga të tjerët u shpërngulën në Serbi. Jovani (Gjon) me bijtë e tij Petrin (Pjetrin) dhe Mirkon u vendosën në fshatin Vishevc, qarku i Lepeniçkit të Kragujevcit. Karagjorgje është djali i Petrit dhe i ëmës Marica (Maria). Autorët në librin "Historia e fshehtë - Karagjorgjët" ("Sakrivena istorija - Kara-



dordeviçi”) me të dhëna të argumentuara, kanë sistematizuar prejardhjen e familjes nga fisi Kelmend (Kliment, siç thonë ata), nga veriu i Shkodrës, nga e ashtuquajtura Shqipëria e Epërme apo Shqipëria e Lartë. Të dhënat arkivore vërtetojnë se për prejardhjen e tyre kanë pasur njohuri të shkëlqyeshme edhe vet Karagjorgjët. Edhe më tepër, mbreti Petar i Parë dhe princi Pavle - i cili më së shumti hulumtoi nëpërmjet kërkuesve të cilët i pagoi oborri mbretëror.

Bashkautorë të këtij publikimi janë gazetari i kompanisë “Novosti”, Milorad Boshnjak, dhe hulumtuesi i pavarur Slobodan Jakovleviq, ndërsa botues janë shtëpitë “LIO” dhe “Dositej” nga Gornji Milanovci.

Një burim tjetër thotë se Karagjorgje ishte i biri i Petrit dhe nip i vojvodës Jovan (Gjon) Mrshiq (Marash) Klimentit (Kelmendi). Babai i Gjorgjës, Petar Jovanoviq Klementi, u shpërngul nga Kelmendi i Malësisë së Shqipërisë dhe u vendos në Malësinë e Sanxhakut e më pas, në vitin 1756, në rrethin e Kragujevcit. Aty i ka lindur djali i tij Gjorgje (Gjergji).

Pra, nga këto fakte del që shqiptari i konvertuar në ortodoks dhe i serbizuar, është themelues i dinastisë sunduese serbe. Para se të arrijë në këtë pozitë të lartë, ai kishte ekzekutuar në Ostruzhnicë, në rrethana të tmerrshme, të atin e tij, e më pas në Topolla edhe vëllain e tij. Karagjorgje, udhëheqësi i kryengritjes së I-rë Serbe të vitit 1804, pas thyerjes së kryengritjes largohet nëpërmes Zemunit në Austro-Hungari. Pas katër viteve në mërgim, udhëheqësi përsëri vjen në Serbi (1817), ku edhe përfundon tragjikisht. Ai u vra me urdhër të rivalit të tij Millosh Obrenoviq, i cili në këtë mënyrë është përpjekur të arrijë favore te autoritetet turke.

Autorët e librit “Karagjorgjeviqët - historia e fshehur”, i referohen “Glasnik Zemaljskog muzeja Bosne i Hercegovine”, të vitit 1910, Nr 22, në të cilin thuhet se një pjesë e fisit Kliment (Kelmend) ka arritur rreth vitit 1737, në rrethinën e vendbanimit Rudnik, gjatë tërheqjes së Ushtrisë austriake nga Sanxhaku. Aty thuhet se në atë kohë arritën rreth 500 familje shqiptare të cilët ishin “shtatsh-

kurtër, të vrazhdë dhe mizorë”, të cilët mezi flisnin serbisht, donin blegtorinë dhe ishin me karakter të qëndrueshëm. Autorët, Bosnjak dhe Jakovleviq, veçanërisht i referohen veprave të Andrija Luburiqit, të cilat janë të botuara në vitin 1937, në të cilat potencohet se fisi ortodoks i Kelmendasve feston Shën Klementin e Romës, të cilën festë gjoja e kanë kremtuar edhe Karagjorgjët. Autorët argumentojnë se këtë festë e kanë festuar Kragjorgje, biri i tij Aleksandri dhe nipi Petri, i cili “papritmas, në Cetinjë mohoi krsne slave” (“kryqëzimin e shenjtë”).

Ata, Boshnjak dhe Jakovleviq, pretendojnë se Mbreti Petri e dinte origjinën e paraardhësve të tij. Mandej, mbreti Petri kishte vlerësuar lart ndihmën që i ofruan Kelmendasit, gjatë tërheqjes së Ushtrisë serbe nëpër Shqipëri në fillim të Luftës së Parë Botërore. Sipas tyre, Kelmendasit e konsideronin mbretin serb pasardhës të tyre.

Këtë fakt më së miri e ka përshkruar Dr. Jovan Tomiq, profesor në Universitetin e Beogradit, mik i madh i Peter Karagjorgjeviqit. Ai, studentëve të tij këtë të vërtetë ua ka prezantuar dhe nga ta ka kërkuar ta mësojnë këtë histori. Megjithatë, historianët serbë këtë të vërtetë



mundohen ta fshehin nga opinioni.

Thuhet se kur u ekzekutua Karagjorgje, bashkë me të u ekzekutua edhe shoku i tij besnik Naumi, i cili nuk u nda nga ai. Prandaj, populli serb e kanë një thënie, “besnik si Naumi”.

Mandej, ekziston edhe një shpjegim për “Naumin grek nga Argirorokastra”. Argirokastra është Gjirokastra në Shqipëri dhe se emri Naum nuk është i shpeshtë te grekët. Ndërsa, te Shqiptarët është shumë i shpeshtë.

Se historianët serbë janë manipulues të shquar, flet edhe një histori interesante për Konda Bimbashin. Fjala është për një shqiptar të dëshmuar dhe një mik i dëshmuar edhe nga serbët, i cili ka rrugën e vet në Beograd, por që me shekuj fshehet origjina e tij shqiptare. Petrit Imami, në librin e tij “Serbët dhe Shqiptarët ndër shekuj” (Samizdat B92, 1998), për Kond Bimbashin thotë se ai ishte komandant i “trupave ‘Epirote’, shqiptar ortodoks nga Epiri”. Bile, edhe historiani tejet i njëanshëm, siç është Vladimir Stojançeviq, i cili në librin e tij botuar nga SANU në vitin 1994 shqiptarët i quajti Albanci (jo Arbanasi apo Arnauti), thotë: “nga beqarët në mesin e kryengritjes serbe ishte Kond-Bajraktari, shqiptari ortodoks nga kufiri i Toskërisë dhe Epirit”, dhe shton se me Kondon serbë të ikur ka “më shumë nga bashkatdhetarët e tij”.

Një bashkëkohës i këtyre ngjarjeve, Lllazar Arsenijeviq Batallaka, tha: “Unë kam njohur shumë të krishterë, në mesin e tyre, bullgarë, greko-shqiptarë (grkoarnauta) dhe cincaro-shqiptarë (cincaroarnauta) që kanë mbetur me serbët kur Gushanac u largua nga Beogradi...”!

Këto raste nuk janë të vetme. Kontribut Kryengritjes së Parë serbe i kanë dhënë jo vetëm shqiptarët, të ikur nga Ushtria turke, por edhe disa fise të krishtera shqiptare (Kelmend, Grudë, Hot...), ndërsa kryengritësit armët i kanë siguruar nga Rrafshi i Dukagjinit, të prodhuar kryesisht nga shqiptarët të përkatësisë fetare islame, kështu që një pushkë e gdhendur me emrin e mjeshtrit “Osman”, e cila ruhet në Muzeun e Kryengritjes së Parë serbe, mendohet se i përkiste Karagjorgjes.



DED GJO' LULI ME DJALIN E TIJ, KOLËN

Nje numer i "historianeve" apo dhe i "studiueseve" per shkaqe qe ata vete i dine, por edhe te disa historianeve me siguri nga mosnjohja e se kaluares, mungeses se hulumtimeve apo dicka tjeter, kur ka te beje me historine (te kaluaren) e Malesise se Madhe, kane bere leshime ne te shkruarit apo pershkrimin e saj. Keshtu kemi ne librin "Baca Kurti dhe mbrojtja e Grudes" (autor Kraja), kur behet thirrja ne burime, ceket se "nuk ka egzistuar Bac Vuksani" dhe se me te duhet kuptuar Baca Kurtin. Pastaj se Kole Kurti dhe Plluc Gjeka (Lumi) jane Gjokaj. E verteta eshte se . Bac Vuksani ka egzistuar dhe eshte babai i Sokol Bacit dhe ka qene bashke me Hak Shabanin, njeri nder kreret kryesore te Grudes ne pjesen e pare te shekullit XIX, kurse Kole Kurti dhe Plluc Gjeka i takojne vellazerise Kalaj. Ketu duhet theksuar se shtepia e pare (vojvoda), trashigimtare e Gjokajve eshte shtepia e Haxhi Ucit Gjokaj. Baca Kurtit I eshte dhene titulli vojvode ne kohen kur perfaqesonte Gruden ne Kuvendin (Mexhlisin) e Tuzit ne tri mandate. Patjeter Baca

Si shpëtoi Dede Gjo' Luli në Vraninë?

Kurti ka qene nje nder kreret kryesore te Grudes ne periudhen e tij. Leshim tjeter mund te cilesihet konstatmi i "historianeve" per pjesmarrjen e Dede Gjo' Lulit ne mbrojtjen e Kalase se Vranines. Pse mund te cilesohet si leshim? Oso Kuka, komandant I pikes kufitare ne ishullin Leshandro (sllavisht Lesendro), per mos t'u dorezuar beri vetvrasje, vrasjen e te gjitha rojeve (19 veta) dhe te 120 ushtareve Malazez. Sipas burimeve malazeze dhe franceze ne kala kane mbetur te gjithë, prandaj eshte e kuptueshme se sikur te kishte qene trimi Dede Gjo' Luli brenda (edhe njehere po ceki se Leshandro ka qene ishull) kishte vdekur ate dite qe eshte bere lufta, me 26 qershor 1862 (sipas burimeve malazeze). Ne vitin 1897 kemi perleshjet dhe konfliktin ne mes katolikeve dhe myslimaneve dhe

shkak i tyre kane qene shkaterrimi i varrezave te katolikeve dhe therja e derrit ne dere te xhamise. Ne lidhje me te edhe Gazmand Shpuza ceke se "per te qetesuar katoliket dhe myslimanet shkuan Dede Gjo' Luli i Hotit dhe Baca Kurti i Grudes". Gje e pamundur kjo, sepse Baca Kurti ka vdekur me 1881, d.m.th. 16 vjet para para ngjarjes.

Me 24 qershor 1883 lidhet Besa emes Hotit, Kastratit dhe Grudes, ne Kastrat, per mbrojtjen e trojeve shqiptare, por Romeo Gurakuqi, Mirash Hasin (Ivezaj), krere i Grudes, nenshkruet i Beses per Gruden bashke me Smail Martinin dhe Sokol Bacin, e ben Camaj (ne librin "Hoti ne rrjedha"). E vertete eshte se ka egzistuar Marash Hasi Camaj, por kete Bese ne emer te Hotit e kane nenshkruar Dede Gjo' Luli, Preke Martini dhe Lulet (Lul) Gjeloshi. Nje "historian" (perndryshe gjuhtar) ne librin "Fiset e Malesise"

(libri II) ceke se me "1910 - 1911 strehim ne Triepsh gjeten Dede Gjo' Luli, Haxhi Zeka, dhe Isa Boletini". E pamundur kur ka te beje me Haxhi Zeken e Pejes. Eshte vrare me 1902 ne Peje nga Adem Zajmi. i njejti autor, mysafir i TV amerokano - shqiptar



KALAJA E VRANINËS

ne Detroid, me rastin e 100 – vjetorit te pavaresise, ne pyetje te moderatorit te programit “pse Dede Gjo” Luli nuk ishte ne Vlore”, pergjigjet “ I doli perpara Esad Pashe Toptani dhe shkoi ne drejtim te veriut te takoje Haxhi Zeken” Njesoj sikurse ne rastin e meparshem. Dede Gj’ Luli eshte takuar me Haxhi Zeken me 1899 sepse qene pjesmarres te Kuvendit te Pejes, por me 1912 s’ ka pasur mundesi te takohet. Po ashtu eshte leshim konstatimi se beteja e (lufta) ne Qafe te Uglave (Hot) eshte bere me 1911, kunder malazezeve. E verteta eshte se ka qene ne shtator 1912 kunder Turqeve. Perseri “historianet” konstatojne se djali i Dede Gjo” Lulit, Gjergji, mbeti ne Deciq me 1911, gje qe nuk eshte e vertete. Eshte vrare ne shtator te vitit 1912 ne mes Tuzit dhe Vuksanlekajve. Ne nje eufori dhe mendim se njihet historia e Malesise, mund te konstatohen edhe sa “te verteta”, sic jane. Se Om Haku eshte nga Drumja (Hot), kure eshte nga Gruda dhe i ka takuar vllazerise Kajoshaj. Se vllazeria e Gjonajve i takon Traboinit (Kahreman Ulqini) kur i takon Rapshes (Hot), se Lulgjurajt jane nga Traboini (Hot) thote Gjovalin Shkurta (Lulgjurajt jane nga Gruda), ne Fjalorin Enciklopedik Shqiptar thuhet se “ Nikolle Ivanaj lindi ne Triepshin e Grudes”. Natyrisht se eshte gabim, Triepshi gjithmone ka qene mal bajrak, zone me vete dhe nuk ka qene dhe nuk eshte pjese e Grudes, po ashtu ne Fjalorin Enciklopedit thuhet se “ Pikala e Hotit” e qe duhet, e Grudes, Dom Nike Ukgjini ne “ Hoti ne rrjedha”, kur flet per Kelmendin, ceke se “ Kelmendi ne pjesen veriore kufizohet me Gruden” Gabim – Gruda dhe Kelmendi nuk kufizohen, i gabuar eshte edhe mendimi i Eqerem Cabej se “ Fudnat kufizohen me Kuc dhe Hot”, kur kufizon (zona Fudna, Luhar dhe Llopar) me Kuc, Koje, Triepsh dhe Grude. Si rezultat i mosnjohjes jane edhe konstatimet e shume personave se Deciqi eshte i Hotit (ne masen 80% i takon Grudes). Po ashtu gabim eshte z. Mahir Hoti (ne “Hoti ne rrjedha”) kur flet per Kelogoshin, Vranen e tjer. Se te Hotit. Jane dhe i takojne Grudes. Ne mesin e leshimeve mund te konsiderohet edhe “ vertetimi” se Hoti luftoi kunder malazezeve me 1849, kur fatkeqesisht ka qene perleshja per kullota dhe Lug te Cemit mes dy vllazerive shqip-

tare Hot dhe Triepsh. Ka mundesi se edhe “vertetimi historik” i shtate kojaseve “qe moren flamurin ne Deciq me 1911” eshte i gabuar dhe jo i sakte. Ne dokumentin “Spisak poginulih i ranjenih boraca 1912. I I 1913. godine” (Lista e luftetareve te vrare dhe te plagosur te viteve 1912 – 1913) eshte e shenuar data e vrasjes me 20 mars 1912, plotesisht te gabuara jane vertetimet e sa historianeve malazez, sic eshte Zhivko Andrijasheviq se “Sokol Baci ka qene agju-tant i mbretit Nikolle’

Kur ka qene Sokol Luci si oficer malazez,



pastaj “ Sokol Baci” ka jetuar ne Cetine” dhe se “me 1925 eshte vrare ne atentat ne Cetine”, kur Sokol Baci kurre nuk ka jetuar ne Cetine (ka jetuar ne Ksheve, Shkoder Stamboll, dhe Podgorice dhe strehuar ne Triepsh dhe Tivar), kurse sa i perket “atentatit ne Cetine” munde te ket ndolle vetem ne fantazine e autorit apo dhe te “autoreve te burimit” sepse Sokol Baci ka vdekur, sipas kalendarit Julian (latin) ne funde te vitit 1919, kurse sipas kalendarit Gregorian, ne fillim te vitit 1920. Autori i “Kryengritjes se Malesise 1911” Gjorgje Nikpreleviq (Gjergj Nikprelaj)

Konstaton se Martin Preka, pjesmarres i Kuvendit te Greces, eshte nga Triepshi dhe ka te beje me Mark Preken nga Boga e Kelmendit, si dhe “Tom Gjoni, krere

nga Ksheva, eshte Nikaj”kur ka te beje me Tom Gjon Shytin Sinishtaj, apo dhe Mark Gjokaj konstaton se Hakshabanajt jane Ivezaj. Hakshabanajt jane Nikaj dhe shtepia e pare ne vllazerine e tyre. Ndue Bacaj ne “Gruda ne Fokus” verteton se “Gruda me 1896nparaqitet si mal i vogel”. Natyrisht se eshte gabim, sepse Hoti, Gruda, Kelmendi, Kastrati dhe Shkreli jane konsideruar bajraqe te medha ose pese bajraqet e medha te Malesise se Madhe. Hoti Lucgjonajt ateher bajraktar te pare. Gojcajt, bajraktar te Traboinit Hot.

Gruda . Ivezajt, bajraktar te pare.

Palajt, bajraktar te Tuzit.

Kelmendi bajraktari I pare del prej shtepis se Ujke Giles Selce. Bajraqe ne kuader te Kelmendit jane edhe Vukli, Nikci dhe Boga.

Kastrati dhe Shkreli kane pasur vetem nga nje bajraktar.

Ka edhe sa e sa “ te verteta”, “zbulime” rreth malesise sic eshte “ se kur lindi Dede Gjo’ Luli iu dhe emri i gjyshit” kur gjyshi i Dedes eshte quajtur Lul (katragjyshi e ka pasur emrin Dede)

Shenim titulli eshte i redaksise.

Marre nga Libri. “Pak Histori ne kohet e Zjarra” Autor Pjeter Ivezaj, Historian nga Gruda



KATEDRALJA E RE E TIVARIT

Arqipeshgvia e Tivarit është një institucion fetar katolik, i Arberisë Veriperendimore vazhdimesi gjithësesi edhe e shqiperise po Veriperendimore. Themeluar si Arqipeshgevi që në vitin 1089. Mjerisht 132 vjet me pare dhe konkretisht, më 8 tetor të vitit 1886 papa Leoni XIII e ndau Kryepeshgevin e Tivarit nga ajo e Shkodres. Sipas një konkordati shqip (vendimi) të marre në marrveshje të plote në mes Vatikanit dhe Qeverisë së at'hershme princërore të Malit të Zi.

C' ka ka bërë që së paku të ketë 120 vite që në Katedralen e Tivarit, edhe pse me Priftërinjë Shqiptarë mesha të mos celebron në gjuhën shqipe. Ashtu siç ndodhi edhe gjatë ceremonisë përuruese të Katedrales së re të Tivarit, e zhvilluar në shtator të vitit 2017. Gjokë Dabaj nga Shestani i pranishëm, në ceremoninë përuruese të 3 shtatorit të vitit 2017. Në Tivar shkruan në revistën "Koha Javore", se këto ceremoni e prita me padurim. Mirpo liturgjia shërbehej kryesisht në gjuhën Sllave, dhe kori i kishës këndonte lutjet po në gjuhën sllave. Duke e ditur që shumica e Klerikeve ishin Shqiptarë, madje edhe Kardinali Ernest Troshani, unë shkruan Dabaj isha i prirur të merrja me mend ndrydhjen shpirtërore që përjetonin ata klerike. Nuk ishte e mundur se ata deshironin për ta thënë meshën sllavishte, në një kishë shqiptare, të mbushur po me besimtarë shqiptarë, pothuajse të gjithë të ardhur nga zona të ndryshme shqiptare. Të Malit të Zi si dhe nga Diaspora, dhe konkretisht vetëm nga New Yorku kanë qenë të pranishëm 82 per-

Pse shqiptarët katolikë ndërtojnë Kisha ortodokse në Malin e Zi?!

sona. Patjetër që ka pasur edhe banorë nga Tivari, por pa e treguar në asnjë rast, të qenit shqiptarë, duke e shpërfillur totalisht gjuhën shqipe. Dabaj me shqetësim shkruan se isha i prirur të përfitoja edhe debatet që ata pra priftërinjet katolikë, mund të kenë bërë në rrethet e tyre të mbyllura dhe presionet që në mënyrë dhe formë të

ndryshme, janë ushtruar mbi ata klerikë dhe se përfundimisht ata kanë qenë të detyruar të veprojnë ashtu. Siç nuk deshironin dhe si Zoti, të cilin ata i besojnë, nuk do ta meritonte kurrë. Shprehja me flagrante e kësaj ceremonie, sqaron Dabaj, e mbuluar me petkun e "Demokracisë", ishte demonstrimi i dy veshjeve Kombëtare, ku njëra veshje paraqiste kostumin malazez. Në një kohë që gjithkush e di që nuk ka në bote as edhe një malazias të besimit Katolik. Të gjithë malazezet janë ose prillav, ose ateist. Katolik janë një numër shtetasish Shqiptarë dhe Kroatë. Por katolik me kombësi malaziasë nuk ka gjekundi. Në një cast tjetër veshja popullore ishte nga fshati Zupc, fshat i cili ka një etnohistori sqaron Dabaj enigmatike. Nderkohe që aty nuk është shfaqur azgje shqiptare, asnjë simbol asnjë dhoj veshjeje, apo dicka tjetër, përveç disa priftërinjeve si dhe të pranishmëve mysafirë në Tivar, sa për atë ditë ceremonie. Të cilët kanë patur rastin të bëjnë edhe një orë mesimi në gjuhën Sllave. Dhe pikërisht në një institucion ose veper kulturi shqiptare siç është katedralja e Tivarit. Ndertimi i se ciles ka kushtuar 3.5 milion euro, para të mbledhura nga Shqiptarët dhe me lobimin e tyre. Si në Vatikan, Itali, Gjermani, S.B.A. e tjerë konkretisht vetëm katolikët shqiptarë në New York kanë dhënë 500.000 dollarë për nderimin e Katedrales së Tivarit. E cila vetëm



KATEDRALJA E VJETËR E TIVARIT

KATEDRALJA E SHKODRËS



meshtarin e ka katolik dhe qe quhet Rrok Gjonlleshaj, pasi per azgje tjetere shqiptare ketu nuk behet fjale. Deshmia me e qart per kte eshte eshe Struktura e ndertimit te Katedrales, e cila eshte e stilit dhe e ritit te Ortodoksise Malazeze, dhe qe kurrsesi nuk ka patur mundesi qe te ndoll ndryshe, ku edhe drejtuesi i punimeve ka qen Malazezi Vllado Caricq, i cili me parat e shqiptareve katolik ka ndertuar kisha ortodokse.

Per ta vertetuar me se miri kte qe po themi, shikojini katedralet e tjera Shqiptare se c'fare ndertimi kane

dhe qe jane me nje kumpaniel, dhe jo me dy ose tre kumpaniela (ku zakonisht vendosen kembanat e kishes). Shiheni se si eshte ndertuar Katedralja Katolike e Shkodres, ajo e Tiranës, dhe se fundmi ajo e Prishtines. Te cilat jane te stilit dhe te ritit Roma - Katolik. Ndoshta dikush ashtu si edhe 132 vjet me pare po mashtron edhe Vatikanin. Apo ndoshta vete vatikani vepron me qellim, ashtu sic po vepron edhe me Kosoven, duke mos e njohur, edhe pse askund tjetere ne Ballkan, nuk gjindet popullsi katolike pervec Shqiptareve dhe Kroateve.

Mark Shkreli, antare i keshillit botues, te revistes " Jeta Katolike" ne New Jork, gjithashtu edhe kryeredaktor i saj. Edhe

ai i pranishem ne Tivar, shkruan dhe citon ne faqen 12 -te te revistes Korrik – Dhjetor 2017. Kryepeshkopi aktual i Tivarit imz.



KATEDRALJA "NENE TEREZA", PRISHTINË



KATEDRALJA E SHËN PALIT, TIRANË

E PAVARUR, INFORMATIVE, HISTORIKE DHE PATRIOTIKE

Rrok Gjonlleshaj, gjithsesi Mark Shkreli ka shprehur edhe shqetësimin e tij, për këtë ceremoni po në faqen 12 -te ku thote se. Nuk mundem mos të permendi disa mangësi nga ky rast, me rëndësi për kishën dhe popullin shqiptar jo vetëm katolik (se ç'fare ka dashur të thote me shprehjen jo vetëm katolik, kështu me mirë se askush tjetër e'di vete z. Shkreli).

I cili sqaron dhe me shqetësim legjitim, se librecat e shtypur enkas për këtë rast, ishte në dy gjuhë, sllave duke i paraprirë dhe duke mbizotëruar shqipen edhe pse përberja etnike e arqipeshgvisë është 95 % shqiptare. Arqipeshgvi e cila sipas të dhënave që në kemi pran gazetës "Zani i Malsisë". Numerom në të gjithë Malin e Zi jo me shumë se 8000 besimtar katolik. Megjithatë sqaron Shkreli Imz. Gashi, disa nga tekstet e shkruara sllavisht, i lexoi shqip. Ç'ka le të kuptohet se me se shumti ka kryer detyrën e perkthyesit për ata që nuk e kanë ditur ose e kanë harruar sllavishten. Befasia më e madhe thote Mark Shkreli në shkrimin e tij, të titulluar Dy Shenjtor në Trojet Shqiptare të Denja për Romen. Ishte paraqitja e dhuratave, të

gjithë të veshur me kostume tradicionale, por asnjë kostum nuk ishte shqiptar gjë që ra në sy të gjithëve. Ishte ky vazhdon Mark Shkreli një zënjim i madh sidomos për në nga diaspora, ai thote në shkrimin e tij kuptohet edhe duke u rezervuar se. Nuk është rasti për kritikë, por nuk mundem mos të permendi edhe një gjë që la pershtypje të hidhëruar, tek ne, fjalimi i Mitropolitit, Amfilohije Radoviq, i cili nuk ngurroi të permend malin Rumi, si shenjëtores të Kishës Ortodokse Serbe, edhe pse dihet qartë se është pa dyshim shqiptare, por e uzurpuar me ndihmën e ushtrisë Jugosllave, duke vendosur në majën e saj një "Konzerve" që ai e quan Kishe.

Drejtuesi i revistës "Jeta Katolike" edhe thote se le të shpresojmë se në Tivar do gjenden shqiptar katolik që akoma nuk e kanë humbur identitetin kombëtar. Me këtë shpresë pasij ajo vdes e fundit, por rrimë edhe në edhe pse ka 120 vite që mesha në katedralen katolike të Tivarit, nuk celebron në gjuhën shqipe, dhe ku nuk flitet shqip nga askush përveç, priftërinjëve katolik shqiptar, edhe ata ndonjëher e flasin shqipen, vetëm njeri me tjetrin. Me këtë

HELMI MALAZEZ

Duke përjetuar gjithë këtë ngjarje, me përzierje të dukshme të një farse mediatike, po me vinin pa pushim në mendje dy vargje të një poeti të madh malazias Peter Drugi Petroviq Njegoshit. "Cashu meda josh niko në popi, shtoj cashon zhuci në zatopi" (Got' n e mjaltit askush dot s' e piu, të paperzier, me gotë helmi të hilet) Në katolikët shqiptarë të atyre hapsirave, të ndodhur në Malin e Zi në Jugosllavi qysh prej vitit 1877 e kësaj, me shumë se pesë breza, pa shërbim kishtar shqip dhe pa shkollë shqipe, sidomos Tivari e Shestani, me shumë e kemi shijuar helmin e mjaltit. Dhe, me sa duket, shpërberja jonë kombëtare e kulturore do të vazhdojë shumë eger edhe në këtë kohë aspiratash të reja. Helmi nuk do të na mungojë.

Gjoko Dabaj

rast po kujtojmë edhe të dhënat e numrit të besimtarëve katolik që janë aktualisht në shtetin e Malit të Zi, si dhe vendet ku ata ndollen. Në komunën e Tivarit janë të rregjistruar 46 besimtar katolik. Në Ulqin banojnë 1800 besimtar katolik. Në Podgoricë përfshi edhe Tuzin me rrethina janë 6000 besimtar katolik. Në Plavë 108 katolik. Dhe në Rrozhajë është vetëm 1 katolik. Që do të thote se Mali i Zi ka vetëm 8000 besimtar katolik. Prandaj me të drejtë lind pyetja se ç'fare fitoi kisha katolike dhe shqiptarët, e gjuha, kultura dhe historia e tyre nga ky investim. Apo si gjithnjë e rëndësishme është që të fitojnë Malazetët sic fituan 3.5 milion euro investim, si dhe një kishë ortodokse, për nderimin e se ciles vetëm katolikët shqiptar ose shqiptarët katolik me banim në New York, kanë dhënë 500.000 dollarë. 82 prej të cilëve nga Tivari kanë shkuar, për të marrë pjesë edhe në përzgjedhjen e katedrales katolike të Prishtinës. Ndoshta për të lare mekatin që kanë bërë në Tivarë.

Vasel Gilaj
New York

Kur Turqia dhe Bullgaria kërkonin bashkimin e Kosovës me Shqipërinë

Ne baze të vendimit të Konferencës së Londrës, në tetor të vitit 1913, erdhi në Vlorë Komisioni Nderkombëtar i Kontrollit. Ai e konsideroi qeverinë e Vlores si pushtet lokal, njësoj si "Pleqesia" e Durrësit dhe nuk lejoi që ajo të bente veprime pa pelqimin e tij. Qeveria e Ismail Qemalit u perpoq t'i shmangej këtij kontrolli. Ajo u orvat gjithashtu të ndermerrte hapa të rinj në kundërshtim me vullnetin e fuqive imperialiste, për të siguruar bashkimin e tokave shqiptare që kaluan nën zgjedhjen serbo-malazeze. Njëkohësisht ajo u perpoq të shtinte në dorë krahinat e jugut, të cilat ndonëse iu njohën Shqipërisë, vazhdonin të qëndronin nën pushtimin grek.


Por në rrethanat e atehershme patriotet mendonin se për zgjedhjen e kësaj detyre ishte e nevojshme të gjendeshin aleatë të jashtëm. Rrethet politike shqiptare i drejtuan sytë të përpjekjet që po bënin Turqia dhe Bullgaria për të formuar një aleancë kundër Greqisë dhe Serbisë. Stambolli dhe Sofia ishin të interesuara që të përfshinin në këtë aleancë edhe shqiptarët. Si shpërblim për pjesëmarrjen e tyre, ata u zotoheshin shqiptarëve që, në rast fitoreje, të debonin greket nga Shqipëria e Jugut dhe të bashkonin Kosovën me Shqipërinë. Bashkëpunimi i shqiptarëve me aleancën turko-bullgare, sipas xhonturqëve, do të arrihej me lehtë në rast se në krye të shtetit shqiptar do të vihej një princ mysliman i caktuar prej tyre. Këto plane i pelqeu edhe Ismail Qemali, icili mendonte se, duke pasur si aleatë Turqinë dhe Bullgarinë kundër Serbisë dhe Greqisë, kishte me

teper mundësi të realizohej bashkimi i tokave shqiptare. Marrveshja ishte e fshehtë. Por me tredhtinë e qarqeve ciftigare, Komisioni Nderkombëtar i Kontrollit ra në dijeni të marrveshjes dhe mori masë për prishjen e saj. Ai arrestoi grupin e parë të forcave turke që po zëbrkonin në Shqipëri nën komandën e Beqir Grebenesë, kurse bëjleret ciftigare hapën një fushatë shpifese, kundër Ismail Qemalit.

Me zbulimin e këtyre planeve dështuan edhe kësaj radhe përpjekjet e qeverisë së Vlores për bashkimin e tokave shqiptare. Mëqenëse afroi koha të vinte në Shqipëri princi gjerman Vilhelm Vid dhe për të lehtësuar formimin e një qeverie të vetme për gjithë Shqipërinë, qeveria e Vlores dhe doreheqjen më 22 janar të vitit 1914.

Nën presionin e Komisionit të Kontrollit dhe doreheqjen edhe "Pleqesia" e Esat Toptanit. Në pritje të princit, i gjithë pushteti u përqendrua në duart e Komisionit Nderkombëtar të Kontrollit. Vilhelm Vidi arriti në Durrës më 7 mars 1914. Esat Pash Toptani u bë ministër i brendshëm dhe ministër i luftës. I Qeverisë Vidi. Më 3 shtator të vitit 1914. Vidi nuk mund të qëndronte me në shqipëri si shkak i protestave, me se shumti fshatare, të organizuara nga Haxhi Qamili. Ai u largua nga Durrësi. Regjimi i Vidit mori fund. E se bashku me të, edhe enderra e bashkimit të Kosovës me Shqipërinë. Enderr që pa dyshim, mundë dhe duhet të realizohet, pse jo vetëm pas pak vitesh.

“Malsori”



Evropa e mësosi gegnishten nga malsorët

Në historinë e përgjakur e përflakur që sollën motet nga njëri shekull në kapërcyellin e tjetrit, një vend tepër të rëndësishëm, madje si simbol të shqiptarisë zë padyshim treva më veriore e Shqipërisë “Londineze”, Malësia e Madhe.

E kjo trevë historinë e saj e shkroi vazhdimisht me jatagan e pushkë, por edhe me pupël e pendë, që në shumtën e rasteve për bojë kishin gjakun e bijave e bijve të saj më të mirë, të cilët u sakrifkuan që të mbijetojë Malësia e vetë Shqipëria. Padyshim

momente lufte e qëndrese në mbrojtje të trojeve tona nga lakmitë e pushtuesve të “largët” e të shovenëve fqinjë nuk kanë pasur së rreshturi, madje sa vetë jeta e kësaj treve që e meriton të quhet krenaria e krejt Shqiptarisë. Por në këtë shkrim të shkurtër, unë siç paralajmërova në titull, dua të kujtoj sadopak një ngjarje që bëri jehonë të madhe jo vetëm në Malësi e Shqipëri, por edhe në kançelari të Europës plakë që sapo kishte filluar të zgjohej nga gjumi i gjatë, ëndrrat e të cilit shpesh na kushtuan mjaft shtrenjtë, por që gjithsesi shqiptarët në përgjithësi e malësorët në veçanti treguan para atdheut e botës se dinë t’i dalin zot çdo pëllëmbë toke që iu lanë amanet të parët, e Zoti i kishte falë këtu para gjithë popujve të tjerë që vërshuan në ditë të vështira njerëzimit.

Natyrisht lufta e gjatë e malësorëve me pushtuesin shumëshekullor turk shpesh bëri që me fqinjët tanë të “vonë” e aspak miqësor (serbo-malazezët) të krijonim bashkëpunime e aleanca në interes të përbashkët, me qëllim çlirim nga pushtuesit mizor turkoshak, por që për fat të keq këto aleanca në përgjithësi u prishën jo për faj të malësorëve e shqiptarëve, por për faj të shovenëve fqinjë, që kërkonin hapësirë tokësore në kurrizin e trojeve tona. Një marrëveshje e tillë kishte pasur të bënte me rastin e luftrave të viteve 1911 e 1912, në luftën kundër turqve, ku thuhej se trevat shqiptare që do t’i çlirojnë malësorët do të ishin të tyre e nuk do t’u binte më në qafë “shteti” malazez, por që edhe pse shqiptarët malësorë çlirojnë trevat autoktone të tyre, si dhe ndihmuan maksimalisht e pa hile edhe çlirim të tokave të Malit të Zi, marrëveshja u prish nga fqinjët, të cilët filluan të pushtojnë troje të Malësisë e Shqipërisë. Qëndresa heroike me pushkë në dorë për të mbrojtur tokat



tona safi shqiptare nuk reshti kurrë, por në këtë kontekst të mbrojtjes së tokave tona, përveç pushkës si shok i pandarë i malësorëve, shkëlqen edhe rruga diplomatike e krenëve të Bajrakut të Kelmendit, që si “koka” e Malësisë e Shqipërisë, jo vetëm nga ana figurative u dërgojnë fuqive të mëdha një Memorandum me vlera të papërsëritëshme, të cilin po e botojmë të plotë më poshtë. E ky memorandum përfaqësonte interesat e krejt Shqipërisë së Veriut e më gjerë dhe u drejtohet autoriteteve Britanike në Londër më 26 maj 1913, kur në atë kohë Britania e Madhe ishte “fuqia” numër një e fuqive të mëdha të Europës që kishin filluar të marrin në dorë disi fatin e popujve të “vegjël” që kishin hequr mbi shpinë mizoritë e perandorisë që po jepte shpirt (Turqisë).

Natyrisht, për ta paraqitur e kujtuar sa më origjinale e me jehonën e kohës e cila ende shëndrit si margaritar në qiellin blu të Malësisë e Shqipërisë, tekstin e plotë të Memorandumit po e riprodhoj me gjuhën e “vjetër” shqipe të Veriut që quhet Gegnishte, e me të cilën të parët tanë u “morën” vesh me Europën Plakë e qytetërimin e saj.

Padyshim kështu memorandumi është disi më i “vështirë” për t’u lexuar, por që shpresoj se për hir të respektit të kësaj ngjarjeje e të parëve tanë do t’na e falin këtë vështirësi, e cila as nuk ka të krahasuar me vështirësitë e panumërta të paraardhësve tanë pa të cilët nuk do ta kishim as këtë “grimë” Shqipëri që kemi sot...

Memorandum

T’nënshkruemt Kreen t’Bajrakut t’Kelmëndit, tuej vûu oroe:

a) se pêsë Malet e Mishkodres: Hoti, Gruda, Kelmëndi, Kastrati e Shkreli, permrênda atyne kufijve nder t’cillt sod me sod gjinden të caktueme, jânë pr kahë gjaku, gjûha, kanûni e doket nja me fise tjera t’komit shqyptaar;

b) se kahë feja jânë nji besimit me Dukagjin, Pukë, Mirditë, Kthellë, Malcië t’Lezhës etj., se prandej ndollin t’ndryshuem prejë Malit t’Zii;

c) se intereset e gjallimit t’tynë gjinden t’lidhuna e t’pershkueme me ato t’krahinës (Vilajetit) t’Shkodres, njaq saa e shumëta pjesë e Malcorve dimnon nder vise t’shtrîme prejë Shkodret deri n’gjyget



t’Kavajës, e qi prandej t’kaluemt e tyne nën sundim t’Malitzii kishte me u pertrii nji rrenim t’madh n’ekonomii;

d) se kto Male per trii vjet rresht kan derdhë gjakun vetun per lirië e perparim t’komit shqyptaar, e se vetun mâs këtii qellimit luftuen sivjet krahas me Malazez, deer si mâs t’mârrunit të Tuzit njoften mëndimin pushtues e jo librues t’Malitzii; e) e se Malazeztm (si tjerët Slav t’Balkanit), gjith kohen e luftës me Turkië kan bîndë marë shekullin e gjytetnuem me mizorii e dhunii t’kryeme mii Shqyptarë e mii katolikë t’Shqypniis, t’cillve u kan djegë Kishë, rrenue eltet, mytë meshtarë, grii fmii e graa, plaçkitë gjâa e pasunii e rroposë me top e me zjarm, kundra ç’do arrsyjet e vullndetit t’Europës, gjytetin e Shkodrës;

f) e se prandej antipatia e saa qind vjetve ndermjet komit shqyptaar e popujve Slav t’Balkanit sod gjindet mâa tepër e egercueme, po mârrim lëjen me ja u paraqitë luten neper mjet t’Madhniis s’Ate atyne Pushteteve t’Mdhaa t’Europës, t’cillat ja kan vûu detyrë vedit me perkujdesue per lirim e perparim t’Shqypniës, si pesë Malet, t’permënduna sypri, me ata kufij ner t’cillt jânë gjetë deer sod t’pershtrieme,

t’perbâjnë nji pjesë t’vetme me Shqypnië t’librueme. Për ndryshe, si n’kohë t’kalueme, nder ata kufij kaa me rrjedhë prap gjak nierit.

Kol Nika, Gjon Neli, Prek Groshi, Gjergj Prëçi, Luk Nika, Gjeto Deda, Prék Zuri, Baza Doshi, Prék Shtiefni, Luc Ujka, Tom Gjoni, Prel Toma, Kol Prëçi, Marash Vata, Pjeter Ndoka, Tom Prela, Pashko Elezi, Mark Kola, Mark Ujka, Pjeter Deda, Zef Pjetri, Zef Gjoni.

E pas këtij Memorandumi teksti i të cilit rrezaton vetëm shqiptari çdo fjalë e jonë nuk do të kishte më vlerë, prandaj po e mbyll këtë shkrim të shkurtër me shpresë se kemi kujtuar sadopak këtë ngjarje e protagonistët e saj që edhe pse tashmë nuk rrojnë më, ata “flasin” për ne e trojet tona që ende lëngojnë nga shovenët fqinjë që mbajnë të ndara jo vetëm troje, por mbi të gjitha zemra dhe shpirtra malësorësh e shqiptarësh. Gjithsesi shpirtrat e këtyre burrave që i dualën zot jo pak Malësisë e Shqipërisë në ato kohë të vështira u bëmshin “ambasadorët” shpirtërorë të malësorëve e shqiptarëve pranë krijuesit e shembuesit të Gjithësisë, Zotit të të gjithëve... që padyshim nuk na ka harruar.

Ndue Bacaj

Gruaja malësore në foto, thesari i trashëgimisë sonë shpirtërore



Nga Albert Vataj

E PAVARUR, INFORMATIVE, HISTORIKE DHE PATRIOTIKE

Pas një shekulli disa nga këto foto janë më shumë se si të tilla, fokus i një aparati, janë një testament i pasurisë shpirtërore të malësorëve. Ato janë zëri i asaj të vërtete që e shkuara, harresa, mospërfillja dhe mungesa e interesimit, janë rrekur ta shtypin deri në asgjësim. Po kishte nga ata që i ruajtën këto visare, i publikuan këto foto, i bënë të njohura kulturave dhe traditave të botës së madhe, si një dëshmi e patjetërsueshme e atyre vlerave qytetëruese që mishëruam ne. Janë këto foto, janë këto gra të memorizuara në këto stampime, që tregojnë historinë, të cilat përmbi të gjitha ngrenë zërin dhe u thonë skeptikëve, asaj nate gojimesh të liga që u përpoqën ta denigronin këtë vlerë, të mos e njihnin këtë pasuri, ta trajtonin si shpellarë këtë identitet.

Jo! Ata ishin të gabuar dhe sot ne jemi të bindur se përtej këtij manifestimi fshihet një prej thesareve më të vlerata të emancipimit tonë. Kjo triumfoi meg-

jithë vështirësitë dhe pamundësitë që e kërcënuan vijimsisht, që nga varfëria deri te tjetërsimi i elementeve shprehës nga ndikesat e prurjeve përmytëse dhe ekspansioneve të kulturave të ndryshme.

E kush më mirë se sa vajza, gruaja, nëna mund ta dëshmojnë këtë qëndresë përballë stuhisë, këtë aftësi dominimi përballë rrëmeteve. Ajo është e bukur, joshëse, delikate dhe me një shprehje heroine.





imit. Ajo tregoi gjithnjë me vlerat e saja gjithëçfarë fsheh brenda vetes, brenda asaj nevoje, forcën e manifestimit të tipareve që e dallojnë atë, jo vetëm nga veçantitë e veshjeve karakterstike, por edhe nga forca e karakterit, vitaliteti amësor dhe ndjenja e zjarrtë atdhetare. Ajo ka ushqyer në ndërkohje interesimin dhe kërshtërinë e grafistëve, piktorëve, kostumografëve, historianëve dhe hulumtuesve të ndryshëm. Dhe ata nga ana e tyre e kanë jetësuar atë, gruan shqiptare, me gjithë gamën e saj dalluese, bukurinë, krenarinë, forcën dhe hiret fine të femrës.



Më shumë se një grua, ajo është e themelta e veçorive dhe karakteristikave dalluese të shqiptarëve, të cilët mbetën në historinë e botës si realitete sfiduese. Vërshuan kohërat, erdhën dhe ikën etapa të ndryshme të traditave dhe emancip-





Shqiptarja, arbëreshe apo arvanitase, e Iliridës apo e Shqipërisë, myslimane apo e krishterë, veriore apo jugore, elitare apo popullore, qytetare apo malësore, nuk i ka lënë indiferent të huajt me veshjen e saj tradicionale.

Madje, shpeshherë, ajo ka ngjallur kureshtje me veçantinë e stilit të saj. Ajo që e dallon atë, ajo shprehi që manifeston prej saj ato vlera dhe attribute të një gruaje me cilësi është vetë ajo, ajo që ka ardhur nga fokusi i aparatit të studjuesve dhe dinastive fotografike shqiptare, ku mund

të veçojmë Marubin. Në atë dëshmi që vjen përmes fotografisë koha ka ndalur dhe kujtesa është nënshtruar asaj force dhe joshjeje, asaj nevoje komunikimi në ndërkohje dëshmimi.

Veshjet popullore, veshjet karakteristike të zonave dhe krahinave, janë pa dyshim një nga manifestimet më të fuqishme të kulturës tradicionale. Ato janë trashëguese të shumë elementëve, që vijnë nga lashtësia dhe nga koha e mesme, por janë njëkohësisht edhe shprehje e marrëdhënieve kulturore me popuj të tjerë gjatë shekujve.

Ndërsa i përcjellim këto foto, shumica e të cilave e ka kaluar shekullin për nga mosha, ne kemi fatin të shfletojmë historinë e etnokulturës, si një nga hallkat më të forta që na mbajnë të lidhur me pasurinë shpirtërore dhe shijen estetike që ata manifestojnë. Sot më shumë se kurrë mund të bëjmë një dallim, një vlerësim, një rishqyrtim të të gjithë atij ansambli shprehës të këtyre vlerave, të kësaj pasurie, të këtij dëshmimi shekullor. Vijnë deri sot, jo vetëm nga fotografitë, por edhe nga kostumet që janë ruajtur nëpër arka dhe sunduqe nusesh dhe plakash.



E PAVARUR, INFORMATIVE, HISTORIKE DHE PATRIOTIKE

Por në këtë parakalim fotografik ne mund të njihemi edhe me veçoritë karakteristike të jetës malësore. Fëmijët, gratë dhe nënat shpalosen përmes këtyre fokusimeve siç ishin, ku varfëria është e kudogjendur. Është kjo plagë që ka gërryer keqas dhe vështirësuar në ekstrem jetën e këtyre malësorëve, por pa mundur dot ta nënshtrrojë, ashtu siç s'ia arriti dot t'i bind sundimit të tyre çfarëdo hordhie barbare që shkëli dhe la kockat në këto troje. Është kjo kulturë, është ajo ndjenjë aristokracie, ai sharm dhe ajo finesë, ajo elegancë dhe ai solemnitet që shfaqet në çdo element të veshjeve, por edhe të shprehisë emocionale që fotografët kanë fiksuar në celuloid.

Qartazi ata nuk janë të hareshme, nuk mund të tregojnë me promovimin e vetes së tyre, më shumë se sa një moment ceremonial, atë të fotografimit, ku ajo, gruaja dhe vajza malësore, shqiptare në themel, ndjehen si në një "ndëshkimore". Gjithsesi ata sjellin të qarta pas më shumë se një shekulli peshën e rëndë të kohës që është gremisur në kurrizin dhe shpirtin e tyre. Janë të vrara nga mundimi dhe vuajtjet, por një dritë shnditëse u buron. Secila

prej tyre ka diçka të veçantë që kërkon të thotë edhe sot, ndërsa ajo prehet diku në truallin e kësaj toke, këtyre shkrepave. Nëse kureshtia jonë e tashme na ka mbahtur të lidhur me gruan e asaj kohe vetëm

përmes Kanunit, ne jemi mjaftuar me një pjesë të papërfillshme të të gjithë veprimtarisë së saj, që nga vajzë e dashur, te nuse punëtore, bashkëshorte e bindur, nënë e përkushtuar, trimnesh dhe sojnikë. Ajo,





gruaja malësore, ajo mbi të cilën ka rënduar pothuaj se e gjithë barra e shtëpisë, ndera dhe sojnija, shërbesa dhe bujaria, është ajo për të cilën kanë shkruar poetë dhe shkrimtarë të famshëm, studiues dhe

historianë, rrugtarë dhe aventurirë, të cilët i hodhi zelli dhe kureshtia në këto male të thepisur, në këtë tokë të ashpër burrash trima e grashë fisnike. Gruaja malësore dhe në tërësinë e saj,



gruaja shqiptare vijnë përmes dëshmimeve fotografike si një aspiratë e lartë e dëshmisë së vlerave që trashëgojmë. Ishtë dhe është ajo grua që ka ditur të jetë një akt shpërblese i krijuesit.

Për gjithë këto foto, këtë riardhje të këtyre bijave, grave, nënave, këtë mall, nostalgji dhe dëshmim historik, për këtë pasuri shpirtërore që mbeti e gjallë, e hijshme, e bukur dhe manifestuese, një mirënjohje meritojnë ata që e bënë të mundur që ky zë, i cili thërret nga thellësia e kohës, të dëgjohej, kjo pasuri që trashëguam në shpirt dhe aspirata qytetëruese, të ruhet si një amanet i të parëve. Ishin ato grishës të kësaj vlere të cilët duke e pikasur e fokusuan, e ruajtën dhe e trashëguan, duke na e dhuruar si një prej thesareve më të çmuara të një kombi. Sepse këto foto, janë kaq të gjalla, sa ç'ka mbetur e tillë në gjakun dhe në ndjenjën tonë kombëtare çdo gjë që ata mishërojnë edhe sot.

Shteti Ilir, krijimi dhe faktorizimi në histori

Me lindjen e klasave antogoniste, gjate shekujve V – IV p.e.s. Linden edhe shtetet e para ilire. Federata ilire u kthye ne nje shtet ilir qysh nga fundi i shekullit V. Pak me vone u kthyen ne shtete me vete edhe federata molose dhe dardane. Ne treven e hapur te ilireve, u formuan gjate shekullit IV edhe shtete te tjera me vete, sic qe shteti i panioneve dhe i liburneve, por keto nuk luajten ndonje rol te rendesishem ne historine e vjeter. Me formimin e shteteve ilire pushteti ra ne duart e aristokracise skllavopronare.

Ne te gjitha keto shtete u vendos monarkia, me ne krye bazileusin, i cili tani u vesh me funksionet e verteta te mbretit. Por autoriteti i mbretit ishte, ne pergjithesi i kufizuar nga keshilli i paresise, i cili ndodhej ne duart e aristokracise skllavopronare. Por ase keshilli i paresise nuk qe ne gjendje te vendoste nje pushtet te centralizuar. Popullatat e ndryshme qe u perfshine ne kufijte e ketyre shteteve, e ruajten, ku me shume e ku me pak, autonomin e vjeter lokale, ne disa raste edhe mbretin e tyre te vecante. Ne shtetin molos, ne fillim, sundonin dy mbreter njekohesisht.

Qytetet Shtete

Gjate shekujve V – IV p.e.s. Ne trven e Ilirise linden nje varg qytetesh te reja, te cilat, se bashku me kolonite e vjetra bregdetare, u zhvilluan nga pikpamja ekonomike e politike me hapa shume te shpejte. Ato u mbushen me zejtare, tregtare e detare, kurse ne periferi me bujq, kopshtare dhe blegtoare. Si kudo edhe ketu zhvillimi i qyteteve u shoqerua me perhapjen e marrdhenieve skllavopronare. Shumica e qyteteve u perfshi ne shtetet Ilire, duke e ruajtur autonomin e tyre te brendshme si Shkodra, Finiqi, Butrinti, Rizoni, Pelioni e tjer. Por disa nga qytete me ekonomi te zhvilluar, si Durresi, Apolonia, Bylis, Amantia, Isa e tjer



u kthyen ne shtete me vete.

Qytete – shtete kishin kufij shume te ngushte. Ato perfshinin qytetin dhe rrethin fshatar shume te afert.

Nga forma e rregjimit re gjitha quheshin republika skllavopronare. Ne krye qendronte prytani, i cili zgjidhej nje here ne vit, formalisht nga kuvendi i qytetareve, kurse ne te vertete nga keshilli i paresise.

Edhe ketu kishte raste kur sundonin dy prytane njekohesisht.


Qyteti – shtet i pare qe u formua ne treven e Ilirise, ishte ai i Durresit. Ai u be qyteti – shtet me i rendesishem, pasi Durresi ne keta shekuj ishte qyteti me i madh i Adriatikut. Durresi preu monedhat e veta te para qysh ne shekullin V. Ketu, vendosja e pushtetit te

aristokrateve ndeshi ne rezistencen e ashpër te demokrateve, me te cilet u bashkuan edhe pronare skllaverish, qe ishin perjashuar nga pjesmarrja ne keshillin e paresise. Konflikti ndermjet aristokracise dhe demokrateve vazhdoi per nje kohe te gjate, derisa ne vitin 436 p.e.s. U kthye ne nje lufte civile. Lufta ne fillim perfundoi me fitoren se demokrateve. Por me vone, ne kete lufte civile u perzien, njeri, pas tjetrit, pothuajse te gjitha shtete e Greqise. Keshtu, duke u nisur nga Durresi, filloi konflikti i gjate e i njohur ne histori me emer “ Lufta e Peleponezit” ndermjet dy koalicioneve te medha greke te kryesuara nga Athina dhe Sparta (431 – 411). Ne kete lufte edhe durrsaket u ndane ne dy pjese aristokratet mbajten anen e Athines, kurse demokratet anen e Spartes. Me fitoren e koalicionit te Athines, aristokratet e rivendosen perseri pushtetin e tyre ne Durres.

Mbreteria Ilire (shekujte V – III p.e.s.)

Mbreteria Ilire shtrihej ne viset e sotme te Shqiperise, Malit te Zi dhe Dalmacise Jugore, afersisht qe nga lumi Vjose deri ne lumin Narone. Ajo kufizohej ne jug me Lidhjen Molose, ne veri me federaten Liburne, ne lindje me shtetin maqedonas dhe federaten dardane. Ne anen perendimore ndodheshin dy qytete – shtete me te rendesishme te Adriatikut, Durresi dhe Apolonia.

Mbreteria Ilire u formua ne cerekun e fundit te shekullit V, ku luftrat me Maqedonine ishin bere te shpeshta. Meqenese peshen kryesore te luftes e mbanin enkeleasit, fqinj me maqedonasit, ne krye te shtetit ilir u vune mbreterit e dinastise enkeleasit. Ne kete periudhe ajo zhvilloi nje politike te jashtme aktive. Ne vitin 423, iliret korren nje sukses te madh, pasi thyen ne kufijte e tyre lindore forcat e bashkuara maqedonase e spartane. Luftrat vazhduan edhe me vone, here me fitore e here, me humbje deisa ne



NUM te snekullit te IV ndermjet mbretëve Ilire e maqedonas u arrit nje marrveshje pajtimi.

Marrveshja duket se nuk u pelqye nga aristokracia e re skllavopronare ilire, pasi mbreti i meparshem u rrezua dhe ne fron erdhi Bardhyli, themeluesi i nje dinastie te re enkelease. Bardhyli sundoi me teper se 30 vjet. Ai u shqua si komandante ushtarak dhe udheheqes politik. Bardhyli i shkeputi Maqedonise mjaft toka, i detyroi mbreterit e saj te paguanin tribute dhe nderhyri shpesh ne ceshtjet e fronit maqedonas. Duke nderhyre ushtarakisht, ai vendosi ndikimin e shtetit te vet edhe ne mbereterin Molose

Por ne fund te jetes se tij, raporti i forcave ndryshoi ne dem te ilireve. Maqedonia u forcua politikisht e ushtarakisht. Mbreti i saj, Filipi II, e hodhi poshte nenshrimin e meparshem ndaj ilireve. Ne ndeshjen qe u zhvillua me 359, Bardhyli u mund. Ai humbi tokat ne lindje te liqenit te Oherit.

Bardhyli vdiq rreth vitit 358. Pasardhesit e tij pesuan disfata te tjera nga Filipi II, i cili tani synonte te nenshtronte shtetin ilir. Ketij synimi ia arriti biri i tij, Aleksanderi i Maqedonise, me betejën qe u zhvillua me 335, ne Pelion, kryeqenderen e shtetit ilire. Aty ushterite ilire, te udhehequra nga Kliti e enkeleasve dhe Glaukia i taulanteve u thyen. Mbreteria Ilire humbi pavaresine. Kjo renie qe e perkohshme. Pasi vdiq Aleksandri (323), mbreteria Ilire e rifitoi pavaresine, kete radhe me mbret Glaukian, nga dinastia e taulante. Ne lufte kunder Maqedonise, Glaukia ne fillim pati pati disa disfata, por pastaj korri suksese te medha. Ai rifitoi tokat e humbura ne lindje, me 312 mori Durresin e Apolonine. Me 309 nderhyri ne shtetin molos, ku vendosi ne fron Pirron, aleatin e vet.

Gjate sundimit te Glaukias, rreziku maqedonas erdhi duke u dobesuar. Por pas vdekjes se tij, Mbreterise Ilire i lindi nga jugu nje rrezik tjetër i madh nga shteti molos, i cili gjate sundimit te Pirros u be fuqia me e madhe e Ballkanit. Pasardhesit e Glaukias nuk qene ne gjendje t'i benin balle presionit epiriot. Ata u futen nen ndikimin e Pirros dhe humben disa vise jugore, nder te cilat Apolonine dhe Durresin. Gjate gjysmes se pare te shekullit III p.e.s. Mbreteria Ilire nuk zhvilloi dot ndonje politike te jashtme aktive. Ajo erdhi duke u dobsuar, derisa rreth vitit 250, me ardhjen ne fuqi te dinastise ardiane, filloi per shtetin ilir periudha e trete e lulezimit te tij politik.

Mbreteria e Epirit gjate shekullit III p.e.s.

Me Epir quheshin ne kohen e vjeter tokat qe shtriheshin afersisht prej lumit Vjose deri ne gjirin e Ambrakise, prej detit Jon deri ne malet e Pindit. Ne kete treve banonin 14 fise, ne veri fise ilire, ne jug fise helene, kurse ne qender popullsi qe i flitnin te dyja gjuhet. Rolin kryesore ne formimin e federates epiriote e luajten moloset ilire, premdaj ajo u quajt "Lidhja molose" ose "Federata molose".

Federata molose mori tiparet e nje shteti epiriot gjate gjysmes se pare te shekullit IV p.e.s. Kur ne fuqi ndollej dinastia molose e Ajakideve. Ne fillim mbreteria epiriote qe shume e dobet per shkak te grindjeve te brendeshme midis grupeve rivale te aristokracise skllavopronare. Por me vone, ne fillim te shekullit III, keto grindje u kapercyen, kur pushtetin e mori ne dore Pirroja

i Epirit.

Pirroja u tregua qysh ne fillim nje sundimtar i shkathet. Ai nuk ndihmoi asnje nga partite e vjetra, por mbrojti interesat e perbashketa te aristokracise skllavopronare e piriote. Pirroja e perqenderoi pushtetin krejtesisht ne duart e veta, ia kufizoi te drejtat keshillit te paresise dhe u dha fund autonomive qe gezonin fiset e ndryshme epirote. Me kete politik, Epiri u kthye ne nje shtet skllavopronare te perqendruar. Ne fushen e jashtme, Pirroja ndoqi nje politike te pavarur, duke mos u afruar as me Maqedonine kunder shtare, as me iliret qe e kishin ndihmuar te hipte ne fron. Perkundrazi, ai ndermori nje sere fushatash, ushtarake, me te cilat i zgjeroi teritoret e shtetit te Epirit duke pushtuar ne lindje viset e Maqedonise deri ne lumin Vardar, ne jug teritoret e Greqise deri ne gjirin e Korinit, kurse ne veri viset e ilireve deri ne lumin Shkumbin, midis tyre edhe Apolonine. Keshtu, mbreteria e Epirit u be per disa kohe shteti me i fuqishem i Ballkanit. Fitoret ia rriten lakmine per pushtime tjera aristokracise epiriote. Rasti i gjend kur Tarenti, nje qytet i Italise se Jugut, u kerkoj epirioteve ndihme per tu





mbrujtur

nga Roma. Ne vitin 280 p.e.s. Ne krye te 30.000 vetave dhe te 20 elefanteve, qe i kishte sjedhe nga Egjipti Pirroja kaloi ne Itali. Ne te dy ndeshjet qe u zhvilluan ne Heraklea (280) dhe ne Askulum (279) epiriotet i thyen keq ushterit romake, por edhe vet pesuan humbje te medha. Pastaj Pirroja se bashku me ushterin epiriotet, shkoi ne Sicili ku korri nje varg fitoresh te reja kunder ushtrise se Kartagjenes, qe kishte pushtuar ishullin. Por lufterat e shpeshta e dobesuan ushterin epiriotet, prandaj pasi

qenderuan gat 6 vjet ne Itali u detyruan te hiqnin dore nga pushtimet e metejshme dhe te ktheheshin ne Epir. Gjate kthimit ato zhvilluan ne Beneventum (273) ndeshjen e tret me ushterin Romake, e cila perfundoi me nje disfate te rende per epiriotet. Pasi u kthye ne Epir, Pirrija ndermori me sukses nje sere fushatash te tjera. Ai sulmoi Sparten, por ne nje ndeshje rruges, qe u zhvillua ne qytetin Argos, ne gjirin e korintit, Pirroja u vra. Pas vdekjes se Pirros, ne Epir shperthyen perseri konfliktet e brendeshme ndermjet grupeve te aristokracise. Konfliktet shpune ne dobesimin e mbreterise se Epirit dhe ne ngushtimin e kufijve te saj. Me 234 vendin e monarkise se perqendruar e zuri republika e federuar, me emrin " Lidhje Epiriote" me kryeqytet Finiqin, afer Delvines.


Mbreteria Ilire nen dinastin ardiane (251 - 168)

Rreth mesit te shekullit te III, Mbreteria Ilire ishte nje shtet i dobet. Fqinjjet e saj ishin si dhe me pare . Epiri, Maqedonia dhe Dardania. Vetem ne veri situata kishte ndryshuar. Federata liburne ishte shpartadhuar perfundimisht, qysh ne shekullin e meparshem, nga dyndjet e kelteve. Me vone keltet kishin sulmuar here pase here edhe tokat e ardianeve. Te cilet banonin ne krahinat veriore te shtetit ilir.

Ne lufte kunder tyre, ardianet kishin krijuar nje organizim te mire ushtarak. Duke shfrytezuar kete organizim, aristokracia skllavopronare ardiane mori ne dore drejtimin e shtetit ilir. Perfaqesuesi i saj, Pleurati, u be sovran i mbar mbreterise. Keshtu ne vitin 251 erdhi ne fuqi nje dinasti e re, dinastia ardiane, e cila sundoi me teper se 80 vjet. Kryeqyteti i Mbreterise Ilire gjate kesaj periudhe ishte Shkodra. Vendin e Pleuratit qe vdiq pas 1 viti (250), e zuri biri i tij Agroni, i cili sundoi 20 vjet. Gjate ketyre dhjetvjecareve, shteti ilir beri hapa te medhenje perpara, ne fushen ekonomike, politike dhe ushtarake. Numeri i skllerverve u shtua dhe rendi skllavopronar u perforcua. Qytetet arriten nje lulezim te shpejt ekonomik e kulturor. Pushteti qenderor u forcua ne dem te autonomive lokale te fiseve te ndryshme. U krijua nje ushtri e forte tokesore dhe nje flote e fuqishme luftarake. U rivendosen kufujet e meparshem, qe nga Vjosa deri ne Narone, me perjashtim te tri kolonive

bregdetare, Durresit, Apolonise, dhe Ises. Mbreteria Ilire u be keshtu nje shtet i forte dhe nje fuqi detare. Lundrimi ne Adriatik u fut perseri, si dikur me liburnet, nen kontrollin e flotes ilire. Pas vdekjes se Agronit drejtimin e shtetit e mori gruaja e tij e pare, Teuta. Duke vazhduar politiken e jashtme te Agronit, Teuta ne vitin 230, nisi kunder Epirit ushterin dhe floten Ilire. Ekspedita perfundoi me sukses. Republika e Epirit u mund dhe hyri nen vasalitetin e breterise ilire. Roberit e luftes Teuta i leshoi, kurse sklleverit qe gjeti ne Epir i solli ne Shkoder. Ate vit iliret korren edhe nje sukses tjeter, zbuane dardanet, aleatet e epiriotëve, qe sulmuan nga lindja. Vitin tjeter, me 229, Teuta iu drejtua qyteteve bregdetare. Meqenese Durresi dhe Isa rezistuan, flota ilire, me komandantin e saj Dhimiter Farin, iu drejtua Korqyres. Ne ndihme te Korqyres erdhi flota e Etolise dhe e Akaise. Beteja navale ndermjet dy flotave u zhvillua ne afersite e ishullit Paksos. Flota greke u shpartallua, kurse iliret pushtuan Korqyren. Pastaj nje pjese e flotes ilire u nis per te bllokuar perseri Durresin dhe Isen. Me keto suksese, Mbreteria e Ilirise u be nga shtetet me te mesha te pellgut mesdhetar.

Kristo Frasheri - Stefanaq Pollo



Ismail Lulani, kumtuesi i epshhit të ngjyrave shpuese dhe poetikës shprehëse




Nga Albert Vataj

Ismail Lulani, ishte dhe mbeti ndër emrat e rëndësishëm të traditës shqiptare të pikturës. Një penel që diti të zgjonte në çdo stinë e në çdo trajtesë, kumtimin e epshhit të ngjyrave dhe të mëkonte me një muzikalitet dehës poetikën shprehëse të subjektit. Kohështrirja në veprimtarinë krijuese dhe gjeografia e sfidës, dëshmuar tek ai një piketë të rëndësishme të artit vizual shqiptar. Llojshmëria e punëve dhe trajtesa e veçojnë Ismail Lulanin, duke e pozicionuar në një kreshtë të lartë të asaj që për ne është jo vetëm matshmëria e së epërmes ku ai e çoi shpirtin e tij koloristik dhe skaliti ligjërimit joshës, për edhe de-tyresë mirënjohjeje për testamentin që la. Stinët janë në tablonë e tij ndalesa të hovshme dhe kumtime të andshme. Pranvera gufon në zjarrin e ngjyrave dhe jepet epshëm në lakimin e trajtës dhe lodrimin e dritëhijeve që të shpojnë si sy të epshëm dhe kureshtues që të ftojnë në ngasje. Vera e grunjtë dhe tafti i amësht i tokës, duart të tendosura dhe mëtime që shkrihen në shkujdesjen e penelatave dhe harbohen

në afshin e hapsirës që rreket t'i përpijë. Vjeshta, stina e shirave dhe melankolisë, kridhet shpirtërisht duke marrë gjithçka nga thellësia dhe amështi, nga zjarri dhe tamli, e duke i miksuar në një trajtesë gjallimi koloristik që vetëm Ismail Lulani duket se mund t'i zotërojë. Dhe vjen ai, dimri, një stinë që ngjeth, një amë që e thërrret me zë buçitës, një ngulm që grish në mallime e andrralla t'kahershme që vërshojnë uturishëm, e shprehen në tablo me gjithë ashpërsinë dhe adhurimin. Gjithçka në dimrin e Lulanit ka një frymëmarrje që huajtet në kreshtat ku plaket bora e në krahnoret ku lyp fluturim shqiponja. Edhe historia është një ndalesë gurgulluese

ngjyrash dhe force shprehëse në pikturën e Ismail Lulanit. Ajo ka nerv dhe dritë, forcë dhe thellësi, ka trajtë dhe ngjyrë, ka një zë që thërret nëpër kohë e që trajtëzohet në ngjyrë, për t'u përjetësuar si një kujtesë që e kërcënon e shkuara. Ai shfleton historinë duke sjellë figurat qendrore të saj në një trajtim krejt origjinal, duke hedhur në to atë shpirt që Lulani ka të mbruar me zërin e jehonave që prekin zenitet e epokës së cilës i përkiste. Portretet kanë qenë dhe kanë mbetur deri në të mbramë të sublimës së tij krijuese, qëllimsi e mëkimit të hijeshisë mëtuese dhe shprehëse të botës së brendshme, të cilat nën shpërthimin e ngjyrave kërkonin të gjenin ëndje për





E PAVARUR, INFORMATIVE, HISTORIKE DHE PATRIOTIKE

ta rrokur dehjen që çliron heroikja e historisë që përfaqësojnë. Ata personazhe, ato figura, ato shprehi, duket se para se të shpërthenin në tablo, kishin kohë që bashkëjetonin me piktorin. Një shpirt lirie duhet të gjente dritën dhe ngjyrën e përjetësisë që t'i ç'burgoste nga mendimet dhe shpirti i tij, për ti shndërruar në fakte dëshmuese historike, për të mbushur zbrastësitë dhe hendeqet që keqkuptimi dhe dashakeqja i mbjellin.

Në veprat e tij, sidomos rreth viteve '80, ndihet prirja drejt pasunimit të paletës piktorike që e ban Lulanin të evidentohet nga tabloja në tablo me një stil të veçantë piktorik, që priret drejt dekorativitetit, kapjes së motiveve të veçanta dhe zgjedhjes së mënyrës së vizatimit të personazheve. Vepra artistike e piktorit Ismail Lulanit gjatë më shumë se 30 vjetëve krijimtari është e gjanë dhe e larmishme. Ai pikturon portrete, peizazhe dhe tablo kompozicionale me temë historike e sociale. Vepra e tij e parë e ekspozuar në publik ka qenë një peizazh nga Hidrocantrali i Vaut të Dejës

(1969). Mbas kësaj Lulani do të ishte i pranishëm me tablotë e tij në të gjitha ekspozitat e konkurset lokale dhe kombëtare. Temat e cikleve piktorike të Lulanit janë frymëzuar nga ciklet e kreshnikëve (Muji dhe Halili, Gjergj Elez Alia), baladat shqiptare (Kostandini dhe Duruntina), historia e popullit Shqiptar (figura e Skënderbeut, Ali Pashë Tepelena, Shote dhe Azem Galica), nga shumë figura dhe ngjarje të Luftës Nacional-Çlirimtare, nga periudha e ndërtimit të socializmit dhe, veçanërisht, nga jeta dhe puna e njerëzve të thjeshtë.

Piktori Ismail Lulani veçohet dhe vlerësohet në pikturën shqiptare si një kolorist, me ngjyra potente, të ngrohta e plot dritë, me personazhe-figura që vizatohen në mënyrë të stilizuar, si një artist që joshet mas jetës së njerëzve të thjeshtë. Mas viteve '90 Ismail Lulani i kushtohet kryesisht peizazhit të zonave veriore Shqiptare, që e ka tërheqe dhe ma perpara shpirtin e tij artistik. Me këto motive Lulani ka krijuar cikle tablosh, që mund të grupohen sipas stinëve të vitit, etj, të tilla si cikli i peizazheve të

vjeshtës, cikli i peizazheve të dimrit dhe cikli i bariut të dhive. Piktura e Lulanit ka një freski koloristike, që duket se buron edhe nga kontaktet e artistit me natyrën si dhe nga ndikimi i artit popullor të trevave veriore, gjë që vihet re veçanërisht në koloritin e ndezur dhe në dekorativitetin e veprave të tij.

Lulani i trajtoi motivet shqiptare të tablove të tij nga disa kandvështrime. Ai mund të quhet me të drejtë si piktori i Shqipërisë së Veriut. Përveç tablove historike, që paraqet në ekspozitat Kombëtare të para viteve '90 ("Dedë Gjo Luli", "Shote Galica", "Çast beteje", "Malësori", etj), Ismail Lulani dashurohet këmbë e kokë me peizazhin shqiptar. Në mënyrë të veçantë, element mbizotërues i peizazheve të tij, përveç bukurisë natyrore, është "motivi baritor". Siç shifet artisti ndihet i lidhur me këtë motiv për shkak të jetës së vështirë dhe të thjeshtë të malësorit – bari në malësi. Figura e barinjve të tij ka krijuar një "personazh – imazh", që e shofim të shfaqet herë në një tablo e herë në tjetrën. Ai është një figurë tërheqëse, më shpesh i moshuar, me veshjet popullore të zonës, të cilin artisti preferon ta pikturojë në mes të dëborës e të dhive të tij. Zakonisht ky personazh paraqitet duke ecur, me pamje nga prapa.





Në përgjithësi vërejmë se veprat e Lulanit pas viteve '90 nisin të kenë një notë të lehtë dramatike, një trishtim dhe heshtje që shpesh japin mesazhe të rëndësishme. Me gjithë atë në veprat e tij magjija ndërthuret me misterin, drita e natyrës me dritën e shpirtit dhe peizazhi dimnor me peizazhin vjeshtor. Ndër to “ndrit i njëjti diell” si në



legjendat shqiptare. Veprimtaria krijuese e Ismail Lulanit shtrihet në sisteme të ndryshme shoqërore. Ai mbetet një nga përfaqësuesit ma të randësishëm të artit shqiptar të shekullit XX.

Ismail Lulani ishte dhe mbeti në panteonin e vlerë të traditës sonë një piktor me individualitet të veçantë në artin e tij, thurur prej një mishërimi thelbësisht tradicional dhe ndjesi të spikatura të ngjyrës dhe linjës, dritëhijes dhe shkujdesjes së lodrimit të penelit mbi tablo. Ai krijoi kohën e vet në pikturë dhe vetë koha la tek ai gjurmë drite që pluskojnë yjshëm në natën e nevojës për dehje ngjyrash dhe trajtash shprehëse

estetike.

Ismail Lulani u lind më 1933 në Tuz, Mal të Zi dhe u shua më 6 tetor të 2002 në moshën 69 vjeçare në qytetin e Shkodrës.

Në moshën 9 vjeçare së bashku me familje vendoset në Shkodrë. Në vitin 1967 mbaron Akademin e Arteve të Bukura për pikturë monumentale, puna e tij e diplomës “Ded Gjo Luli me trima”, u vlerësua mjaft nga kritika e kohës. Emërohet dhe punon si profesor në Akademinë e Arteve në Tiranë dhe më pas vendoset me dëshirën e tij në qytetin e Shkodrës ku punon si profesor në Liceun Artistik të këtij qyteti deri sa del si piktor në krijimtari të lirë. Ai ishte një ndër themeluesit e degës së arteve vizive (në shkollën e mesme artistike Prek Jakova) në qytetin e Shkodrës. Ai ishte gjithashtu anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë. Ismail Lulani është një ndër piktorët më origjinal e më të fuqishëm në historinë e artit Shqiptar, ai ishte një piktor shumë aktiv në krijimtarinë e tij, eksploroj me mjeshtri në të gjitha gjinit e pikturës, si kompozim, pejsazh, portret, natura të qeta, etj. Pikturat e tij shquhen për forcën dhe lojrat magjike të ngjyrës, për vizatimin ekspresiv dhe mjetet shprehëse. Për meritat e tij ai është nderuar me çmime dhe tituj të kalibrit të lartë

Në vitin 1979 i jepet titulli “Piktor i Merituar”

Në vitin 1989 i jepet titulli i lartë “Piktor i Popullit”

I është akorduar titulli “Naim Frashri I klasit të Parë”

Në vitin 1999 në Biennialen e Romës për Artet Visive merr çmimi i dytë dhe i jepet medalja e argjente, me tabllon (Ikja në Egjipt)

Pas vdekjes, në 70-vjetorin e lindjes iu akordua titulli “Krenaria e Shkodrës”, i cili i'u dorëzua të shoqes së artistit.

Ismail Lulani morri pjesë në të gjitha ekspozitat lokale që u zhvilluan në qytetin e Shkodrës si dhe ato kombëtare që u zhvilluan në Tiranë, rreth 20 punime të tij ndodhen në arkivat e Galerisë Kombëtare të Arteve në Tiranë, si dhe shumë të tjera pronë e galerive e muzeumeve në qytete të ndryshme të Shqipërisë.

Ai ka ekspozuar në shumë vende të huaja si Frascat ,Romë (Itali), Paris(Francë), Linz (Austri), New York, Boston (USA),



Toronto (Canada), Athin (Greqi), Pekin, Shangai (Kinë), Irlandë, Rumani, Belgjike, Beograd(Serbi), Podgoric, Cetinj, Tivar, Ulqin (Montenegro), Prishtinë (Kosovë), Aleksandri (Egjipt), Turqi , Tunizi, Hungari, duke marë vlersimet më të larta nga kritika e huaj. Shumë nga pikturat e tij janë pronë e koleksionistëve të ndryshëm në Francë, Austri, Itali, USA, Gjermani, etj. Ai mbetet një nga emrat më të respektuar të Shkodrës dhe një nga emrat më të shquar në historinë e artit shqiptar.



EURO PHOTOGRAPHY & VIDEO

*Wedding, Baptism, Party
All Occasions*



Weddingphoto Europhotography-Tani.com

778 LYDIG AVENUE BRONX NY 10462

646-468-8482 or 347-293-6029

dritanhaxhia@gmail.com